

VLERESIM I SITUATES SOCIALE & EKONOMIKE

NE RAJONET E SHQIPERISE

UNICEF Shqiperi

20 Dhjetor 2000

PERMBAJTJA

PARATHENIE

FALENDERIME

LISTA E TABELAVE

HYRJE

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KAPITULLI I PARE: PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I STUDIMIT

- A. Objektivat e studimit
- B. Metodologjia e studimit
- C. Probleme dhe kufizime
- D. Definicionet e perdorura

KAPITULLI I DYTE: REZULTATE TE STUDIMIT

- A. Demografia dhe levizjet migratore
- B. Situata ekonomike
 - 1. Treguesit kryesore ekonomike
 - 2. Tregu I punes
 - 3. Pagat
- C. Mireqenia Sociale
 - 1. Aresimi
 - 2. Shendetesia
 - 3. Mbrojtja Shoqerore
- D. Politikat institucionale
 - 1. Qeverisja lokale
 - 2. Projektet
 - 3. OJQ-te
 - 4. Media

KAPITULLI I TRETE : VLERESIMI I SITUATES

- A. Varferia
- B. Grupet me probleme te vecanta
- C. Treguesit e integruar

REKOMANDIME

BIBLIOGRAFI

SHTESA 1 & 2

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Ndryshimet ne popullsine e qarqeve, 1994-1996
Tabela 1.1	Dendesia e popullise, 1997
Tabela 1.2	Ndryshimet ne popullsine urbane ne disa qytete, 1990 – 1997
Tabela 2	Ndermarrjet e huaja dhe te perbashketa ne qytete, 1999
Tabela 2.1	Ndermarrjet e huaja dhe te perbashketa sipas aktivitetit, 1999
Tabela 3	Klasifikimi I rajoneve sipas punesimit dhe sektoreve , 1998
Tabela 3.1	Klasifikimi I rajoneve sipas nivelit te punesimit, 1998
Tabela 4	Papunesia ne 1998,si perqindje e forces aktive per pune
Tabela 5	Informacion shtese mbi papunesine e regjistruar
Tabela 5.1	Papunesia ne vite ne nivel kombetar dhe rajonal
Tabela 6	Familjet qe perfitojne ndihme ekonomike te pjesshme si perqindje ndaj popullise
Tabela 7	Numri I shkollave dhe kopshteve, 2000-2001
Tabela 8	Treguesit e sistemit parauniversitar, 1999-2000
Tabela 8.1	Buxheti I aresimit ne vite
Tabela 9	Femijet e regjistruar ne aresimin parashkollor, fillor, tete vjecar dhe te mesem sipas vendbanimit, viti 2000-2001
Tabela 10	Braktisja e shkolles, niveli fillor dhe tetevjecar, 1998-2000
Tabela 11	Mesuesit e aresimit parashkollor, 2000-2001
Tabela 12	Mesuesit e aresimit fillor, 2000-2001
Tabela 13	Mesuesit e aresimit tetevjecar, 2000-2001
Tabela 14	Vdekshmeria foshnjore sipas rajoneve
Tabela 15	Sherbimet e kujdesit shendetsor
Tabela 16	Sherbimet e kujdesit shendetsore ne spitale per garte dhe femijet
Tabela 17	Personeli mjeksor
Tabela 18	Shpenzimet publike per qendrat mjeksore dhe spitalet
Tabela 19	Ndihma e jashtme ne sektorin shendetsor sipas rajoneve dhe donatoreve
Tabela 20	Ndihma ekonomike ne vite
Tabela 21	Shperndarja e institucioneve te kujdesit social
Tabela 22	Buxheti I kujdesit social ne vite
Tabela 23	Qendrat e trajnimit profesional ne Shqiperi
Tabela 23.1	Kurset e trajnimit profesional te ofruara nga institutet publike te trajnimit
Tabela 23.2	Klientet e qendrave te aresimit profesional
Tabela 24	Qendrat jo shteterore te trajnimit
Tabela 24.1	Qendrat private te trajnimit
Tabela 24.2	Shkollat pilote te trajnimit te profesional
Tabela 25	Kontributi I donatoreve sipas projekteve
Tabela 26	Media ne Shqiperi
Tabela 27	Besueshmeria ne informacionin e grumbulluar
Tabela 28	Treguesit e varferise sipas prefekturave
Tabela 29	Familjet qe perfitojne ndihme ekonomike sipas zonave urbane dhe rurale
Tabela 30	Familjet qe perfitojne ndihme ekonomike sipas vendbanimit dhe numrit te anetareve
Tabela 31	Karakteristikat e familjeve me te ardhura per njesi konsumi nen 40 – 50 % te medianes
Tabela 32	Klasifikimi I familjeve qe perfitojne ndihme ekonomike sipas indeksit te perjashtimit social
Tabela 33	Treguesit e varferise se integruar

PARATHENIE

Kthesat e shumta në rrugën e tranzicionit kanë shkaktuar brenga të panumërta tek populli shqiptar. Lëvizjet e pakontrolluara dhe masive demografike, papunësia, braktisja e shkollës, vdekshmëria foshnjore, varfëria janë fenomene që kanë ndikuar negativisht ne popullsinë shqiptare gjatë dekadës së vështirë të sapo mbyllur. Për ata që punojnë në fushën e zhvillimit social dhe ata që hartojnë politikat sociale ka qenë tepër e vështirë të mbledhin – në rastin më të mirë “të arnojnë” - informacionin e pamjaftueshëm, por te domosdoshem mbi situatën ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Shqipërisë. Akoma më e vështirë është të sigurosh një tablo kombëtare të treguesve të rëndësishëm mbi gjendjen sociale nga pikëpamja kritike.

Vlerësimi aktual është rezultat i pyetësorëve dhe studimeve të detajuara të zhvilluara në të gjitha krahinat e Shqipërisë nga një ekip i kompletuar dhe kompetent kërkuesish nën drejtimin e United Nations Children’s Fund (Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara). Është hera e parë që një paketë gjithëpërfshirëse të dhënash mbi treguesit socialë dhe ekonomikë, ne pergjithesi mbi mirëqënien njerëzore është përgatitur për të gjithë vendin. Është gjithashtu hera e parë që janë paraqitur dhe analizuar të bashkërenduar tregues të ndryshëm socialë, tradicionalisht të parë veçmas. Ky vlerësim do të provojë se do të jetë i vlefshëm në përcaktimin e një kuadri më të qartë mbi varfërinë dhe përjashtimin social të qytetarve dhe grupeve shoqerore – fenomen që nuk mund të kuptohet plotësisht vetëm i parë në terma ekonomikë.

Përveç trungut të pasur të të dhënave, ky vlerësim përmbledh edhe një numër hartash të detajuara, të cilat synojnë të paraqesin ndarjen gjeografike të disa prej treguesve dhe të ndërhyrjeve sipas zonave. Në se në tërësi këto harta portretizojnë përqëndrim të ulët të arritjeve sociale në zonat veriore dhe lindore të Shqipërisë, një studim më i kujdesshëm i tyre dëshmon “xhepa” të thellë të ndërhyrjes sociale edhe në krahina të tjera.

Ndërkohë që Shqipëria po bëshkërendon forcat për të ulur varfërinë dhe për të ndërtuar një shtet të sigurtë dhe të fortë, një nga mesazhet më të rëndësishëm të këtij vlerësimi është thirrja urgjente për të vënë nevojat e fëmijëve, të grave dhe të rinjve në ballë të këtyre përpjekjeve. Kjo është e domosdoshme jo vetëm sepse këta janë më të varfërit e Shqipërisë së varfër, por është urdhërore sepse Shqipëria nuk mund t’i lejojë vetes të humbë brezin e ardhshëm të pasurisë së saj njerëzore. Imagjinoni veten në moshën e pjekurisë në tablonë e sotme shqiptare. Cilat janë perspektivat tuaja? Ka ardhur koha që të përqëndrohemi te çdo fëmijë shqiptar, si edhe tek ata që mbajnë barrën e rëndë për të siguruar jetën e tyre, nënat dhe baballarët.

Ne kemi besim se ky raport do të bëhet një nga burimet themelore për të gjithë ata që po punojnë për të siguruar udhëkalimin e Shqipërisë drejt stabilitetit dhe drejtësisë sociale.

Roberto Laurenti
Perfaqësues
UNICEF Shqipëri


FALENDERIME

Falenderime te vecanta per grupin e specialisteve, I cili ne menyre te sukseshme realizoi projektin e vleresimit te treguesve sociale dhe ekonomike te rajoneve te Shqiperise. Zj.Vilma Kolpeja, Drejtore e Studimeve ne Qendren Kombetare Shqiptare per Studime Sociale pergatiti pyetsorin. Ajo se bashku me Zj.Mirela Muca, Drejtore e Politikave Sociale ne te njejten qender grumbulluan te dhenat mbi zhvillimin e sistemeve te ndihmes dhe perkujdesit shoqeror. Prof.Dr.Illir Gedeshi, Drejtor Ekzekutiv I Qendres per Studime Ekonomike dhe Sociale analizoi te dhenat rreth zhvillimit ekonomik te Shqiperise gjate dekadës se fundit. Z.Blendi Ceka, specialist I shkencave sociale nga Institutti I Studimeve Bashkekohore, siguroi te dhena rreth zhvillimit te sektorit aresimor. Z.Zef Shala, specialist I zhvillimit te tregut te punes, kontribuoi ne mbledhjen dhe zhvillimin e informacionit mbi drejtime te ndryshme te politikave te punesimit. Te gjithë sebashku ata analizuan te dhenat dhe pergatiten nje raport te pergjithshem vleresues te treguesve ekonomike dhe sociale te rajoneve te Shqiperise.

Vleresime te vecanta per kompanine “GIC Albania”, qe pergatiti hartat e Shqiperise. Kompania e ndihmuar nga grupi I specialisteve, transformoi informacionin e grumbulluar ne forma te dukshme, duke pasqyruar realitetin e sotem social te Shqiperise.

Se fundi, falenderime per mbeshetjen e dhene nga Znj. Arlinda Ymeraj, pergjegjese per vleresimin dhe vezhgimin e projekteve, e cila pergatiti projektin dhe koordinoi zbatimin e tij, dhe Z. Dale Rutstein, pergjegjes per komunikimin dhe informacionin tek UNICEF-Tirane, I cili ndihmoi ne pershtatjen dhe pergatitjen e tekstit final te raportit.

SITUATA SOCIALE DHE EKONOMIKE (sipas treguesve te integruar)



HYRJE

Shqipëria hyri në vitin 1991 në rrugën e reformave të thella politike dhe ekonomike që synonin krijimin e një sistemi demokratik nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe rritjes së nivelit të jetesës në një ekonomi tregu. Pavarësisht sipërfaqes së vogël (28,748 km katror), popullsisë 3,2 milion dhe pasurisë natyrore, Shqipëria ishte dhe është akoma një nga vendet më të varfëra në Europë. Përpara 1990, Shqipëria i perkiste kampit socialist, por në të vërtetë ajo ishte krejtësisht e izoluar, vendi më i panjohur në Europë dhe rrjedhimisht, një nga vendet më të panjohura në botë. Në momentin e kalimit nga socializmi në kapitalizëm, të dhënat mbi zhvillimin ekonomik të kampit socialist dëshmonin për një ndryshim të thellë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera socialiste.

Në vitin e parë të tranzicionit (1992) rena në të gjithë treguesit ekonomikë vazhdoi, por një vit më vonë filloi rritja ekonomikë. Qëllimi urgjent i reformës së tranzicionit për të stabilizuar ekonominë dukej të ishte arritur. “Stabilizimi u arrit shpejt dhe zhvillimi pozitiv i treguesve makroekonomikë e klasifikoi Shqipërinë si një nga nxenesit model të FMN.”¹ Në vitin 1997, shteti u rrezua dhe stabiliteti politik u trondit thellë. Rrezimi masiv i skemave financiare piramide në vitin 1997, i pasuar nga demonstrimet e dhunës me pasoja dramatike politike, dëshmuar për influencën e paketit socialë dhe paqëndrueshmërinë e një rritje të tillë ekonomikë. Në harkun kohor të disa muajve, Shqipëria u kthye mbrapa në vite.

Pavarësisht nga masat e thella të ndermarra në drejtimin fiskal dhe strukturor gjatë periudhës 1997-1998, problemet politike, ekonomikë dhe sociale ende ekzistojnë. Ritmi i rritjes ekonomikë ishte i ulët, më i ulët se në vitin 1994-1996. Qetësia dhe siguria ishin të demtuara rëndë. Mbi të gjitha vështirësitë e brendshme, konflikti në Kosovë destabilizoi situatën në të gjithë Ballkanin dhe rriti tensionin politik brenda vendit.

Megjithatë sipas shenjave treguesit e ekonomisë shqiptare janë përmirësuar që nga konflikti i fundit, treguesit socialë dhe shëndetsorë mbeten të pazhvilluar. Procesi i rindertimit, ndonëse i ngadalshëm dhe i brishtë, është evident. Synimet pozitive makroekonomikë të vitit 1999 dhe 2000 përballen me probleme të thella kritike sociale si emigracioni, shperberja sociale dhe vecanerisht me kapacitetet e pazhvilluara në dhenien dhe sigurimin e shërbimeve sociale. Shumica e shqiptarëve jetojnë në një realitet të zymtë social, me pak shpresa për ndryshim të shpejtë në të ardhmen e afert. Një nga pasojat më të rënda të ndryshimeve ekonomikë të vendit ka qenë dhe mbetet dobësia e vazhdueshme të strukturave të mbrojtjes sociale.

Ky raport synon të paraqisë një analizë të problemeve socio-ekonomikë sot në Shqipëri, sipas shpërndarjes gjeografike dhe administrative, si edhe sipas prioritetëve, nëpërmjet grumbullimit dhe analizës së të dhënave aktuale në nivel bashkie dhe komune. Në këtë kuader, ky raport siguron informacion bazë për ata që përgatisin politikë dhe projekte. Duke marrë shkas nga ky informacion, ekspertët mund të propozojnë dhe vënë në jetë nderhyrjet e nevojshme me qëllim përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave të mbrojtjes sociale në nivel kombëtar dhe lokal.

FMN, “Shqipëria nga izolimi drejt reformave” faqe 1

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Popullsia

Mbeshetur ne te dhenat zyrtare te vitit 1997, popullsia e Shqiperise llogaritet 3,35² milione banore, nga te cilet 51 perqind i takojne seksit femer. Shqiperia karakterizohet nga nje popullsi me moshe mesatare relativisht te re rreth 28,6 vjec dhe ku grupmosha nen 19 vjec perben 42 perqind te popullsise totale. Sipas vleresimeve te bera nga INSTAT-i jashte Shqiperise kane emigruar rreth 600.000 shqiptare kryesisht te seksit mashkull³. Levizjet e brendeshme migratore kane ndryshuar brenda nje kohe te shkurter raportin midis popullsise rurale dhe asaj urbane. Aktualisht popullsia urbane eshte rritur nga 36 perqind ne vitin 1989 ne 46 perqind ne vitin 1997. Brenda 10 vjeteve te fundit, rajonet e Tiranes, Durresit dhe Fierit karakterizohen nga rritja e popullsise afersisht 2 here, ne kontrast me zvogelimin ne te nejtat permasa te popullsise se rajoneve Kukës, Shkoder dhe Diber. Rregjistrimi i fundit i popullsise ne 1989, tregoi se 93 perqind e popullsise shqiptare perbehej nga shqiptare dhe 7 perqind i takonin pakicave kombetare si greke, vlleh, malazeze, maqedonas dhe rome. Pjesa me e madhe e pakicave kombetare jane te perqendruar ne kufirin me Greqine, rreth Liqenit te Ohrit, ne zonat malore te Korces, ne kufirin me Malin e zi, ndersa romet banojne ne te gjithë vendin.

Treguesit Ekonomik

Pas vitit 1990, fillon ristrukturimi I ekonomise nga ajo e centralizuar ne ate te tregut. Gjate 1989-1992 PBB ra ne masen 50 perqind, ndersa Inflacioni ne fund te 1992 kapi shifren 226 perqind. Megjithe permiresimet e ndjeshme deri ne vitin 1995 (PBB-ja arrin nivelin me te larte te rritjes me 11 perqind, ndersa inflacioni ulet deri ne 6 perqind⁴), kriza e vitit 1997 zhvereson cdo arritje. PBB rritet nga -7 perqind ne 1997 ne + 8 perqind ne 1999, ndersa inflacioni ulet nga 180 perqind ne 1997 ne 0 ne 1999⁵. Sektori I sherbimeve, bujqesia dhe ndertimi kane rritje te dukeshme. Sipas te dhenave zyrtare kontributi qe jep sektori i sherbimeve ne totalin e PBB eshte rritur nga 15 perqind ne 1992 ne 17 perqind ne 1997, ai i bujqesise nga 37 perqind ne 1992 ne 55 perqind ne 1995, nderkohe qe ka renie te ndieshme prodhimi industrial nga 40 perqind ne 1992 ne 11,5 perqind ne 1995. Pamvaresisht treguesve Shqiperia vazhdon te jete nje nder vendet me te varfere te Europes. Te ardhurat per fryme ne vitin 2000 kapin shifren 810 USD⁶

Tregu I punes

Punesimi - Sipas vleresimeve te bera nga INSTAT-it ne 1999 kishte 1,065,104 te punesuar nga te cilet 19 perqind ne setorin shtetor buxhetor dhe jo buxhetor, 10 perqind ne sektorin privat jobujqesor dhe 71 perqind ne sektorin privat bujqesor. Gjate 1992-1999, sektori privat jo bujqesor ka pesuar rritje dhe karakterizohet nga biznesi i vogel dhe vetepunesimi. Punesimi ne kete sektor kap shifren 102,000 te punesuar ose 10 perqind e totalit te punesimit dhe eshte me i pranishem ne zonat urbane te rretheve Tirane, Fier dhe Durres. Punesimi ne sektorin bujqesor perben 71 perqind te punesimit dhe ne vitin 1999 numeronte 761,000 te punesuar.

² INSTAT, Vleresim viti 1997.

³ Vleresim INSTAT (Instituti Kombetar I Statistikave)

⁴ UNDP, Raporti I Zhvillimit njerezor ne Shqiperi, 1998

⁵ INSTAT, Shqiperia ne shifra, 2000

⁶ Raport I Bankes Boterore, 2000

Sektori shteror gjate kesaj periudhe ka pesuar renie te dukshme dhe sot numeron 200,000 te punesuar ose 4 here me pak se ne 1989.

Papunesia - Sipas statistikave zyrtare ne vitin 1999 niveli i papunesise kap shifren 18 perqind te popullsise ne moshe pune. Nderkohe qe papunesia eshte me teper fenomen urban dhe reflektohet ne treguesit e papunesise se rregjistruar ne zyrat e punes, nenpunesimi (under-employment) eshte fenomen rural. Ne zonat urbane te rretheve Kucove (42 perqind), Kurbin (40 perqind), Permet (33 perqind), Shkoder (28 perqind), Berat (27 perqind), Elbasan (22 perqind) papunesia eshte me e larte se niveli mesatar. Karakteristike e papunesise eshte se ka ulje te lehte ose te njejtin nivel ne qytetet e medha si Tirana, Durresi Korca dhe Fieri por eshte ne rritje te vazhdueshme ne Permet, Shkoder, Kurbin, Tropoje etj. Papunesia eshte me teper e pranishme tek te rinjte ku mbi 60 perqind e tyre jane nen moshen 34 vjec.

Aresimi

Sistemi publik arsimor parauniversitar perfshin rreth 4,327 shkolla dhe kopeshte te shtrira ne 36 rrethe, 64 bashki dhe 310 komuna. Gjate vitit mesimor 1999-2000 numri i nxenesve ne aresimin parauniversitar ishte 727,275 nxenes nga te cilet 11 perqind i takojne arsimit parashkollor, 75 perqind arsimit tetevjecar dhe 14 perqind arsimit te mesem. Gjate po ketij viti arsimor u angazhuan 38,607 mesues dhe edukatore ose 4 perqind me pak se ne vitin 1998.

Gjate 10 vjeteve te fundit sistemi arsimor ne pergjithesi dhe shkolla ne vecanti, kane qene objekt i reformave ristrukturuese. Me financimet e Buxhetit te Shtetit, Bankes Boterore, Komunitetit European, UNICEF, Fondacionit SOROS, ECHO-s, etj, jane rikonstruktuar rreth 48 perqind e shkollave egzistuese dhe jane ndertuar te reja rreth 4 perqind e tyre ne rrethet Tirane, Elbasan, Fier, Mallakaster, Mirdite, etj

Nje nder problemet me serioze te aresimit eshte braktisja e arsimit te detyruar tetevjecar. Perqindja e gruppmoshes qe duhet te ndjekohe aresimin tetevjecar eshte ulur nga 95 perqind ne vitin 1990 ne 75 perqind ne vitin 1997. Me serioze paraqitet gjendja e femijeve te cilet nuk regjistrohen ne shkollat. Ky problem eshte me i ndjeshem ne zonat te karakterizuara nga levizje te fuqishme migratore, si Kamza, Paskuqani, etj. Disa vleresime deshmojne ne zonat e siperpermendura se rreth 35 perqind te femijeve ne moshe shkollore nuk jane te paregjistruar ne shkollat. Braktisja e shkolles mbetet fenomen masivisht rural.

Mbipopullimi i zonave urbane, kryesisht i rretheve Tirane (Kamez, Paskuqan) dhe Durres (Katund i Ri, Shijak, Sukth) ka krijuar probleme te cilat lidhen jo vetem me shperndarjen gjeografike te shkollave, por edhe funksionimin normal te oreve mesimore ne shkollat egzistuese. Ne zonat urbane numri i nxenesve per nje klase eshte ne rritje. Ne te gjitha qytetet ky numer i kalon kuotat normale dhe arrin ne deri 45 nxenes per nje klase ne aresimin tetevjecar dhe ne 34 nxenes per nje klase ne aresimin e mesem. E kundert eshte paraqitja ne zonat rurale. Shperndarja e madhe teritoriale e komunitetit dhe numri i ulet i nxenesve per cdo klase ka cuar ne krijimin e klasave mikse me deri 18 nxenes per shkollen tetevjeare dhe deri 15 nxenes per shkollen e mesme si ne Himare, Kala e Dodes, Cudhi, etj.

Shendetsia

Ne Shqiperi aktualisht operojne ne nivel komuniteti 2,168 qendra mjeksore pa shtreter (poliklinika, qendra shendetesore dhe ambulanca), 51 spitale rrethesh, 1,562 konsultore te nenes, 1,615 konsultore per femije, 92 qendra te planifikimit familjar dhe 743 farmaci. Tranzicioni i veshtire ka lene gjurme edhe ne sistemin shendetesor. Treguesi ne ulje i jetegjatesise mesatare nga 72 vjec ne 70.5 vjec, niveli i larte ne pergjithesi i mortalitetit

infantil dhe ne menyre te vecante ne rrethet Lezhe, Bulqize, Diber, Kucove, Kukes Berat dhe Elbasan, niveli I larte I mortalitetit memesor I theksuar ne rajonet Kukes, Lac, Diber tregojne veshtiresi te ketij sistemi ne zonen verilindore ne vecanti dhe ne menyre te pergjitheshme ne zonat rurale.

Procesi I levizjeve te pakontrolluara dhe pamundesia per te rregjistruar keto levizje kane demtuar procesin normal te vaksinimit, kujdesit per femijet dhe kontrollin periodik te tyre. Pamvaresisht shifrave, mbi 94 perqind BCG apo 99 perqind per polio, ne realitet vaksinimi I femijeve duhet te jete me I ulet. Ky problem eshte present ne zonat e largeta rurale dhe ne zonat e vendbanimet e reja te te ardhurve pas vitit 90. Qendrat mjekesore pa shtreter u bene objekte te shkaterrimit dhe okupimit kryesisht ne zonen verilindore. Sot zona verilindore dhe juglindore e Shqiperise ka edhe numrim me te vogel te qendrave shendetore per cdo 10,000 banore qe leviz nga 0.9 deri deri ne 10 qendra per cdo 10.000 banore. Mungesa e infrastruktures qe lidhet me rruget, mjetet ne raste urgjence e deri tek nderlidhja me radio apo telefon con ne rritjen e rasteve te urgjencave te patrajtuara nga personeli I kualifikuar.

Varferia dhe grupet e rrezikuara

Grupet te rrezikuara dhe varferia ne Shqiperi nuk identifikohen vetem me te papunet apo me familjet qe jetojne ne varferi ekonomike. Ato perfaqsohen gjithashtu dhe me kategori te cilat jane te perjashtuara nga te drejta themelore per te patur nje banese, nje ushqim te mjaftueshem, ngrohje dhe veshje ne dimer, pune ne perputhje me aftesite fizike dhe nivelin aresimor, shkollë afer shtepise dhe mundesi per ta ndjekur ate, sherbim primar shendetesor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, te drejte dhe ze per te kerkuar te drejtat.

Ne Shqiperi jetojne nen nivelin zyrtar te varferise rreth 146,000 familje.⁷ Ne rajonin e Dibres, Elbasanit, Kukesit dhe Shkodres trajtohen me ndihme ekonomike nga 25 perqind deri ne 35 perqind te familjeve qe jetojne ne territorin e tyre. Mungesa e e ardhurave nga punesimi jo veten ndryshojne ne nivel rajonal por gjithashtu edhe brenda nje rajoni. Ne rajonet e mesiperme perqind e familjeve qe mbeshteten me e adhura te pjeseshme nga ndihma ekonomike eshte me i larte ne zonat rurale dhe shkon deri ne 75 perqind te popullsisë.

Programi i mbeshtetjes se familjes me te ardhura (ndihma ekonomike) per shkak te pagesave teper te ulta, nuk i ndihmon familjet per te dale nga varferia. Varferia, injoranca, problemet ne sistemin aresimor dhe ate shendetesor ndikojne direkt ne perjashtimin e ketyre shtresave nga shoqeria.

Megjithese se mungojne te dhena zyrtare ne nivel komunitar, grupet e rrezikuara aktualisht perfaqsohen nga: femije ne risk (femije qe abandonojne shkollen, femije jetime, femije qe punojne, femije te abuzuar apo te perfshire ne gjakmartje), gra ne risk (te papuna, kryefamiljare, me dhune brenda familjes, te trafikuara apo prostituta), te moshuar te vetmuar te paaftë per tu kujdesur per vehten, te rinj ne risk (perdorues te droges, alkolit, abandonues te shkollës, te rinj te papune, te rinj te perfshire ne aktivitet kriminal, etj), te paaftë dhe invalide. Skemat aktuale te mbrotjes shoqerore, sistemi aresimor, shendetesor, gjygesor apo policor jane te pamjaftueshme te mbrojne apo te integrojne keto kategori ne jeten normale. Popullsia e zonave rurale eshte me teper e ekspozuar ndaj fenomeneve te perjashtimit social.

Pushteti Lokal

Pas vitit 1992, reforma institucionale i hapi rruge decentralizimit te pushteti lokal dhe fuqizimit te veteqeverisjes lokale, nepermjet krijimit te pushteteve te pavarura lokale dhe delegimit te

⁷ Nivel zyrtar I varferise konsiderohet niveli I pamjaftueshmerise se te ardhurave per te cilat familja klasifikohet si e pershtatshme per te perfituar ndihme ekonomike

disa sherbimeve direkt tek ky pushtet. Aktualisht ne Shqiperi, njesite administrative lokale ne Shqiperi jane 64 Bashki, 310 Komuna dhe 12 Qarqe. Dy te parat perbejne nivelin baze te qeverisjes vendore ndersa Qarku nivelin e dyte. Pas 1998 thellohet procesi i decentralizimit I cili materializohet ne 1999 me miratimin e kushtetutes dhe ne 2000 me nenshkrimin e Kartes Europiane per Autonomie Lokale. Aktualisht, strategjia afatshkurter e decentralizimit synon permiresimin e sistemit ligjor dhe financiar te pushteve locale, ndersa ajo afatgjate synon ngritjen dhe zhvillimin e sherbimeve socaile aresimore dhe shendetesore ne bashki dhe komuna te administruara dhe finacuara nga vete pushtetet lokale.

KAPITULLI PARE : PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I STUDIMIT

A. Objektivat e studimit

Studimi ka si qellim kryesor vleresimin e kushteve sociale dhe ekonomike te njesive lokale administrative (bashki dhe komuna) ne 36 qarqet e Shqiperise. Nepermjet analize se tregueve, demografike, ekonomike, aresimor, shendetesor, te punesimit dhe papunesise, varferise dhe marginalitetit social, studimi realizon nje vleresim te nivelit aktual te zhvillimit te sherbimeve publike, identifikon fushat per nderhyrje sipas prioriteteve, nevojave dhe shperndarjes territoriale.

Studimi i siguron organizmave dhe institucioneve qe kontribuojne ne fushen e zhvillimit social si edhe donatoreve elemente te rendesishem dhe rekomandime per hartim politikash nderhyrjeje si edhe sherben si orientues ne procesin e hartimit apo rishikimit te projekteve ne funksion te nevojave aktuale praktike. Gjithashtu, studimi identifikon shkallen e nderhyrjes me projekte nga ana e pushtetit qendror, atij lokal, organizatave nderkombetare dhe organizatave joqeveriate si edhe nivelin e kooperimit midis tyre.

B. Metodologjia e studimit.

Studimi i nevojave ekonomike dhe sociale te 12 qarqeve dhe 36 qarqe, bazohet ne kombinimin e informacionit prej burimeve **primare** me informacion **sekondar**. Per te perfutuar informacionin primar jane realizuar 75 intervista individuale me nenpunes te administrates publike te sistemit arsimor, shendetesor dhe mbrojtjes sociale ne nivel rajonal, rrethi, bashkie dhe komune. Gjithashtu, pjese e burimit primar, jane edhe intervistat individuale me nenpunes dhe drejtore ne Ministrine e Aresimit, Shendetesise, Punes dhe Ceshtjeve Sociale, Ministrise se Rendit.

Si burim sekondar, eshte perdorur informacioni statistikor dhe jo statistikor zyrtar i raportuar nga Ministrite e mesiperme si edhe raporte te UNDP, B. Boterore, INSTAT-it, ECHO-s, Observatorit Kombetar te Shqiperise, UNFPA.

Informacioni cilesor dhe sasior, i marre nga intervistat individuale, eshte terhequr nepermjet nje pyetesori te strukturuar me pyetje te hapura. Pyetesori eshte i ndare ne 10 seksione sipas aktivitetit te 4 ministrive te perfshira ne studim. Gjithashtu pjese te vecanta te pyetesorit jane te shoqeruara me tabela statistikore me ane te cilave eshte terhequr informacioni zyrtar statistikor ne nivel rrethi, bashkie apo komune. Hartimi i pyetesorit dhe i seksioneve te vecanta te tij, eshte realizuar nga eksperte te fushes se aresimit, shendetesise, ceshtjeve ekonomike dhe sociale te cilen perdoren eksperiencen personale dhe njohurite e marra ne kontaktet e fazes pregatitore.

Mbledhja e te dhenave dhe pregatitja e raportit ka kaluar ne 3 faza :

Faza e pare identifikimi i problemeve dhe hartimi i pyetesorit (dy jave)

Faza e dyte vendosja e kontakteve dhe intervistimi i drejtuesve lokal, mbledhja e informacionit statistikor (4 jave)

Faza e trete analiza e informacionit dhe dhe pregatitja e draft raportit (2 jave)

Per lehtesimin e mbledhjes se informacionit brenda nje kohe te shkurter u krijuan tre grupe me nga 2 specialiste.

C. Kufizime

Studimi vlereson, nga pikpamja sasiore dhe cilesore, nje numer te konsiderueshem sherbimesh te fushes aresimore, shendetesore dhe sociale. Ai gjithashtu identifikon dhe vlereson nevojat e nje numri te madh grupesh shoqerore, per keto sherbime. Studimi synon te luaje nje rol te rendesishem ne nxitjen e studimeve me te plota dhe ne pregatitjen e strategjive te nderhyrjes per zbutjen e varferise ne Shqiperise nepermjet permiresimit dhe zhvillimin e sherbimeve ne fushen e shendetesise, aresimit, punesimit dhe mbrojtjes sociale, ne nivel bashkie/komune. Studimi ne vetvete ka kufizime te cilat lidhen me disa kushte:

Koha teper e shkurter, gjate se ciles duhet mbledhur nje informacion te shtrire gjeografikisht ne gjithë, njesite administrative te Shqiperise dhe per ceshtje qe lidhen me demografine, zhvillimin ekonomik shendetesine, aresimin, sherbimet sociale, kriminalitetin, etj.

Gadishmeria dhe profesionalizmi i nenpunesve te administrates lokale dhe qendrore per te pranuar intervisten apo per te plotesuar tabelat me te dhenat statistikore, mbi te cilat bazohet studimi. Ne 31 raste ky disponibilitet ka munguar totalisht, ndersa ne 15 raste te tjera eshte dashur nderhyrja e bashkepunetoreve dhe e miqve, me vendbanim ne komunitet.

Mungesa e te dhenave statistikore ne nivel komune/bashkie per nje pjese te mire te treguesve qe lidhen me punesimin, papunesine, emigracionin, kondicioni terheqjen e tyre nepermjet intervistave me nenpunes lokale. Kjo menyre mbart pasaktesine e cila shprehet ne diskordancen e te dhenave ne nivel rrethi midis raportimeve statistikore dhe raportimit nga keta nenpunes dhe eshte kryesisht e lidhur me shkallen e njohjes se fenomenit, perkushtimit dhe profesionalizmit.

Periudha ne te cilen u mblodh informacioni. Mbledhja e te dhenave ne terren u realizua gjate periudhes para dhe pas zgjedhore per pushtetin lokal. Ky fakt ka ndikuar negativisht ne marrjen e te dhenave ne nivel komunitar kryesisht mbi grupet grupet vulnerable.

D. Perkufizimet e perdorura (shih Shtesa 1)


KAPITULLI DYTE : REZULTATE TE STUDIMIT

A. DEMOGRAFIA DHE LEVIZJET MIGRATORE 1990-2000

Te dhena te pergjithshme

Ne vitin 1989, popullsia e Shqiperise numeronte 3,2 million banore dhe kishte nje ritem vjetor rritjeje prej 1.9 perqind, si rezultat i nje niveli te larte te lindeshmerise per nje grua, me rreth 3,02 femije, dhe nje niveli te ulet te vdekshmerise se te rriturve. Deri ne kete vit, rreth 2/3 e popullsisë banonte ne zonat rurale, migrimi i brendshem ishte i kufizuar dhe i kontrolluar nga shteti, ndersa migrimi i jashtem nuk egzistonte.

Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale pas vitit 1990, krijuan premisa edhe per ndryshime demografike. Pamvaresisht se rregjistrimi i fundit i popullsisë daton vitin 1989, vleresime te kryera nga INSTAT-I, tregojne se aktualisht popullsia e Shqiperise eshte e barabarte me 3,35⁸ milione banore dhe ka nje shtese natyrore vjetore, prej 1.3 perqind. Ulja nga 1,9 perqind ne vitet '80 ne 1,3 perqind ne vitet '90, vjen, kryesisht nga uljet e lindjeve, nderkohe qe vdekshmeria ka mbetur ne te njejtat nivele. Kushtet e veshtira ekonomike, vendosja e kontrollit mbi lindjet nepermjet praktikimit te planifikimit familjar, niveli i larte i emigracionit, rritja e moshes se martesës, kane ndikuar ne uljen e lindjeve per nje grua ne deri 2,7 femije, per periudhen 1990 –1995.



Aktualisht mosha mesatare e popullsisë eshte 28,6 vjec . 42 perqind te saj e ze grupmosha nga 0 - 19 vjec, ndersa popullsia mbi 60 vjec, ze vetem 11 perqind. Ndarja e popullsisë ne femra dhe meshkuj eshte pergjithesisht e ekuilibruar dhe femrat zene 51 perqind te popullsisë. Vleresime tregojne se edhe ne vitet ne vazhdim popullsia e seksit femer do te kete epersi te lehte, ndaj popullsisë se seksit mashkull.


Procesi i Urbanizimit.

Nga 1950 – 1960, zhvillimi i sektoreve industri dhe ndertim sollen nje urbanizim me ritme te larta, gje qe e coi popullsinë urbane ne 30 perqind. Periudha 1961 –1990 karakterizohet nga nje strategji qe frenoi urbanizimin dhe rezultati ishte fakti qe ne Shqiperi ne vitin 1989, popullsia urbane perbente vetem 35.7 perqind ⁹. Periudha pas vitit 1990, e deri sot, karakterizohet nga mungesa e strategjise mbi urbanizimin dhe me heqjen e kontrollit mbi levizjen e lire te njerezve brenda dhe jashte vendit. Levizjet e brendeshme migratore po ndryshojne brenda nje kohe te shkurter raportin midis popullsisë rurale dhe asaj urbane. Aktualisht popullsia urbane eshte rritur ne 46 perqind nga 36 perqind ne vitin 1989.


⁸ Vleresim i bere ne vitin 1997.

⁹ Prof. Vladimir Misja. “ Shoqeria perballe Urbanizimit” Korrik 1998.


DENDËSIA E POPULLSISË SIPAS RRETHEVE



LEVIZJA NATYRORE DHE MIGRATORE E POPULLSISE NE RRETHIN E TIRANES



Ndryshimi i raportit popullsi urbane dhe rurale, sipas viteve



Rritja e popullsisë urbane ka ardhur nga zhvendosjet e pakontrolluara deri ne kaotike te popullise rurale jo vetem drejt zonave urbane brenda nje rrethit, por edhe nga nje rreth ne tjetrin. Nga te gjitha rrethet ka levizje te brendeshme migratore por rrethet me te prekura nga largimet jane rrethet e zones verilindore (Dibra, Kukesi, Tropoja, Puka) dhe ato jugore (Tepelene, Skrapar, Pogradec), nderkohe qe rrethet me te prekura nga ardhjet jane Tirana, Durresi dhe Fieri. (Shtesa 2, Tabela 1.2)

Brenda 10 vjeteve te fundit, rajoni i Tiranës (Tirana, Kamza, Vora, Paskuqani), Durresit (Durresi, Katund i Ri,) dhe Fierit karakterizohen nga nje shtim i popullsisë afersisht 2 here me shume se shtesa natyrore per shkak te ardhjeve migratore, nderkohe qe popullsia e rajoneve Kukës, Shkoder, dhe Diber eshte pakesuar per shkak te largimeve. Tirana, Durresi Fieri jane edhe qarqet ne te cilat dendesia e popullsisë per km², eshte mbi 2 here e larte se niveli mesatar nacional. (Tirana 344 banore per km², Fieri 207 banore per km², Durresi 324 banore per km². (Shtesa 2, Tabela 1 dhe Tabela 1.1)

Sipas vleresimeve te bera nga INSTAT-i, jashte Shqiperise llogaritet te kene emigruar rreth 600.000 shqiptare ose 18 perqind e popullsisë. Pjesa me e madhe e tyre i takon seksit mashkull¹⁰ dhe jane te grup-moshes 20-30 vjec¹¹. Vendet ne te cilat jane edhe vendosjet me te medha migratore jane Greqia me rreth 400,000 emigrante dhe Italia me rreth 150,000. Megjithesese se nuk ka te dhena te sakta mbi shperndarjen e gjeografike te emigracionit jashte Shqiperise, vleresohet se Tirana, Durresi, Lezha, Vlora, Fieri, Gjirokastra dhe Saranda jane edhe rrethet me perqind me te larte te popullsisë ne emigracion jashte Shqiperise.

B. SITUATA EKONOMIKE

1. TREGUESIT KRYESORE EKONOMIKE GJATE 1990-2000

Për të patur një panoramë sintetike për evolucionin e situatës ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 1990 - 2000, është e domosdoshme të njihen, qoftë edhe në përgjithësi, tiparet themelore të ekonomisë shqiptare në prag të viteve 90'. Periudha e gjatë e vetizolimit që përjetoi Shqipëria në sistemin socialist, e shoqëruar me një politikë ekonomike voluntariste e me prirje autarkike, cuan në krijimin e një strukture të çekuilibruar, të prapambetur e konservatore, që mbështetej në sundimin absolut të pronës shoqërore dhe drejtimin e centralizuar nga shteti. Per kete arsye, cilido që i shqyrton ritmet e rritjes së ekonomisë shqiptare për periudhen nga viti 1951 deri ne vitin 1990, verën se ato bien në mënyrë tendeciale, pesëvjeçar pas pesëvjeçari. Kjo si rezultat i shterimit të burimeve të rritjes ekstensive. Shtesa e investimeve paksohet që nga gjysma e viteve 70', pas ndërprerjes së

¹⁰ Sipas vleresimeve te INSTAT-it, mendohet se 70% e emigranteve i takojne seksit mashkull.

¹¹ UNFPA, "Programme review and strategy development report", 1997;

ndihmës ekonomike nga Kina, duke arritur nivelin më të ulët në periudhën 1986 - 1990. Kriza strukturore u ndërthur gjatë viteve 80' me një krize koniunkturale që u shpreh edhe në racionimin e një pjese të produkteve ushqimore, në rritjen e inflacionit dhe të papunësisë, në staniacionin dhe pastaj në rënjen e të ardhurave reale për frymë.

Gjendja tepër e vështirë ekonomike ishte pasojë edhe e mungesës së stabilitetit politik të vendit, të cilat pengonin hartimin dhe zbatimin e një strategjie të qëndrueshme dhe afat-gjatë për reformat ekonomike. Qeveria e dalë nga zgjedhjet pluraliste të vitit 1992 ndërmoi një reformë të gjerë ekonomike liberale, të improvizuar dhe me elementë të theksuar të terapisë shok. Kjo politikë shkaktoi depresionin e thellë të prodhimit industrial, i cili vazhdoi deri në fund të vitit 1994.

Në fund të vitit 1996 u duk një përkeqësim i ri i gjëndjes ekonomike të vendit. Me fillimin e vitit 1997, këto tendenca u thelluan gjithnjë e më tepër, duke e çuar vendin drejt një kolapsi të ri ekonomik dhe shpërthimi social që shënoi shokun e dytë për ekonominë shqiptare. Aspekti më i dukshëm i kësaj krize është shëmbja e institucioneve informale financiare që filloi në fund të nëndorit 1996. Këto institucione shtriheshin në territorin e tërë Shqipërisë dhe kishin grumbulluar gjatë një periudhe 2-4 vjecare kursimet e mbi 1/3 të numrit të përgjithshëm të familjeve shqiptare, të cilat vlerësohen në rreth 1,2 miliard USD¹².

Në mars të vitit 1999 ekonomia shqiptare pësoi një shok të tretë nga ardhja e rreth 500.000 refugjatëve kosovarë, që u shpërngulën me dhunë nga politika e spastrimit etnik, e ndjekur nga regjimi i Milloshevicit. Infrastruktura e brishte e vendit u dobesua me tej nga fluksi I papritur I popullsisë. Pa ndihmen e shtetit publike te afta per te perballuar nje shtate te tille, shqiptaret u perkujdesen per nevojat e refugjateve me bujari dhe mikpritje.

Një karakteristikë tjetër e tranzicionit ekonomik në Shqipëri është ekstroversioni¹³ i tij, domethënë konsumi i brendshëm është më i madh se prodhimi, ndërsa diferenca mbulohet nga transfertat private të emigracionit shqiptar dhe ndihma e organizmave ndërkombëtare. Nga viti 1991 deri në fund të vitit 1999 Shqipëria pati një ndihmë të jashtme të konsiderueshme nga Komuniteti Europian. Ndërsa dërgesat e emigracionit shqiptar gjatë viteve 1991 - 2000, si mesatare vjetore, kanë qënë rreth 400 - 450 milione USD. Nga pikpamja e injektimit të flukseve financiare, e krahasuar me ekonominë e tjera në tranzicion të Evropës qëndrore e lindore, si pasojë e përmasave të vogla dhe emigracionit të madh, Shqipëria është i vetmi vend që përngjan në këtë aspekt me Gjermaninë e Lindjes.

Dhjetë vjet pas zbatimit të kësaj politike, inflacioni në vitin 2000 ra në 3 perqind, defiçiti buxhetor në 9,6 perqind, kursi i këmbimit ka qënë thuhetse stabël gjatë tre viteve të fundit, ndërsa rritja ekonomike vjetore pas 1997 ka qënë rreth 8 perqind. Këto arritje përbëjnë padyshim një sukses relativ të tranzicionit shqiptar. Por nëqoftëse do të përdorim edhe disa kriteret e tjera vlerësimi¹⁴, më të gjëra se ato që përmëndëm, do të shohim se prodhimi industrial nuk ka arritur akoma nivelin e 1989, defiçiti i bilancit tregtar është në rritje, megjithë dinamikën e eksportit, ndërsa papunësia masive vazhdon të jetë e lartë. Të gjitha këto dukuri janë shoqëruar me ndryshime të thella në strukturën e GDP. Industria nga degë kryesore, e cila në vitin 1989 dha 41,3 perqind të GDP, jep aktualisht vetem 12 perqind te saj. Kurse bujqësia kaloi nga 35,5 perqind ne vitin 1990 në 52,3 perqind në vitin 1999. Struktura ekonomike kaloi nga një disekuilibër në tjetrin.

¹² MALAJ A., MEMA F, "Karakteristikat dhe efektet e tregut jo zyrtar financiar", Ekonomia dhe Tranzicioni, 1998.

¹³ SAMSON I., Albania experience among transition trajectories, Working Paper, Grenoble 1996.

¹⁴ KOLODKO G. E., Stabilisation, récession et croissance dans les economies postsocialistes, Economie prospective internationale, 1992, No. 51.


Disekuilibri i ri u shfaq edhe në zhvillimin rajonal të vendit, që erdhi si pasojë e krizës dhe e zhvillimit të pabarabartë ekonomik. 70 përqind e investimeve direkte të huaja janë përqëndruar në aksin Tiranë - Durrës, ndërsa pjesa tjetër në zonat perëndimore dhe jugore të vendit. Investimet direkte të huaja dhe krijimi i ndërmarrjeve të reja nga kapitali vendas, kanë qënë faktori kryesor që ka përcaktuar hapjen e vendeve të reja të punës, nivelin e të ardhurave të popullsisë, ritmet e zhvillimit ekonomik e social sipas rretheve, etj. (Shtesa 2, Tabela 2 dhe Tabela 2/1)

2. TREGU I PUNES

Deri në vitin 1989 bilanci i forcave të punës përbehej vetëm nga popullsia ekonomikisht aktive që punonte, nderkohe që papunesia ishte nocion i panjohur, pamvaresisht se në realitet papunesia e fshehur kapte shifren 7 përqind. Reformimi strukturor i ekonomisë pas vitit '90, u shoqërua me rënie të kërkesës për fuqi punëtore dhe emigrimin jashtë Shqipërisë të rreth ¼ të popullsisë në moshe pune ku një pjesë jo e vogël i takon edhe pjesës me të kualifikuar.

Sipas INSTAT-it në 1999 punësimi përfshin 82 përqind të forcave të punës ose 1,065,104 të punësuar nga e cilet 19 përqind në sektorin shtetëror buxhetor dhe jo buxhetor, 10 përqind në sektorin privat jobujqësor dhe 71 përqind në sektorin privat bujqësor. Kjo situatë është totalisht e ndryshme nga ajo e vitit 1989. Bilanci i fuqisë punëtore të këtij viti, tregon se egzistonte vetëm sektori shtetëror i cili numëronte 1,440,000 të punësuar, prej të cileve 551.000 i takonin sektorit bujqësor.


Bilanci i forcave të punës në 1989 dhe 1999



Punësimi : Vitet 1990-1993 janë edhe vitet në të cilat mbyllet edhe numri më i madh i ndërmarrjeve shtetërore dhe për pasojë janë edhe vitet me shkurtime drastike të të punësuarve. Në 1990 punësimi ra 2 përqind, në 1991 me 4 përqind në 1992 me 25 përqind dhe në 1993, me 30 përqind. Rënia e punësimit në sektorin shtetëror filloi të zëvendësohej me punësimin në sektorin privat të sapo krijuar dhe të brishtë. Në 1992, në sektorin privat kishte 60.000 të punësuar, në 1994 ky sektor numëronte 46,000 ndërmarrje private kryesisht të biznesit të vogël me 103,000 të punësuar ose të vetëpunësuar, në 1996 me 59.000¹⁵ ndërmarrje private dhe 116.000 dhe në 1999, 56,000 ndërmarrje me 103,000 të punësuar dhe vetëpunësuar. Një vend të rëndësishëm në punësimin pas viteve 90, ka luajtur sektori bujqësor. Përfundimi i privatizimit të tokës bujqësore krijoi fermerin private dhe sektorin privat bujqësor që numëronte në 1999, 761.000 të vetëpunësuar dhe të punësuar. Nderkohe që sektori privat bujqësor dhe jobujqësor ka rritje, sektori shtetëror ulet ndieshëm dhe gjithnjë e më shumë ai përfaqësohet nga punësimi në sektorin buxhetor në administratën qendrore dhe lokale të cilet zënë në 1999, edhe 64 përqind të punësuarve në sektorin shtetëror.

¹⁵ INSTAT, 1997

Punesimi sipas sektoreve ne vite



Punesimi ne bujqesi ka njohur rritje dhe ne vitin 1999 perbente 72 perqind te punesimit. Gjithashtu rritje ka pesuar edhe sektori i sherbimeve i cili perbente 21 perqind te te punesuarave, nderkohe qe industria peson rnie dhe perben vetem 7 perqind e te punesuarve nga 34 perqind ne vitin 1989. Punesimi ne sektorin shteteror dhe sektorin privat jobujqesor ka pesuar ndryshime nga viti ne vit. Nderkohe, qe punesimi ne sektorin shteteror shenon ulje nga 41 perqind te forcave te punes ne 1992, ne 15 perqind ne 1999, sektori privat shenon rritje me perjashtim te viti 1997, nga 4 perqind ne 1992, ne 8 perqind ne 1999. Analiza ne nivel rrethi, tregon se punesimi ne keto dy sektore dhe qe kryesisht eshte i lidhur me zonen urbane, ndryshon. Rrethet me nivel me te ulet punesimi te forcave te punes rezultojne te jene Dibra, Malesia e Madhe, Peqini, Permeti, Lushnja, Kavaja, Hasi, Puka ne te cilat punesimi eshte ne nivelet 11-15 perqind te popullsisë aktive. (Shtesa 2, Tabela 3 dhe Tabela 3/1)

Papunesia : Niveli I papunesise u ul nga 27 perqind ne 1992 ne 18,4 perqind ne 1999. Karakteristike e papunesise eshte papunesia afatgjate. Gjate 1993 papunesia afatgjate perbente 63 perqind te papunesise ndersa sot kap 80 perqind te saj. Papunesia eshte me teper e pranishme tek femrat dhe ne moshat e reja. 21 perqind e popullsisë femerore te afte per pune eshte e papune ndersa mbi 60 perqind e te papuneve te rregjistruar, jane nen moshen 34 vjec.

Ndersa **papunesia** eshte me teper fenomen urban dhe reflektohet ne treguesit e papunesise, **nenpunesimi (under-employment)** eshte fenomen rural. Sipas te dhenave ne Berat, Elbasan, Kurbin, Shkoder, Permet dhe Kucove, papunesia eshte me e larte se niveli mesatar prej 18.4 perqind. Ne qytetet e medha si Tirana, Durresi Korca, Elbasani dhe Fieri, niveli i papunesise ne 1999 krahasuar me 1994¹⁶ ka ulje ose qendrim ne te njejtin nivel, ndersa ka rritje ne Permet, Shkoder, Kurbin, Kucove, Lezhe, Skrapar, Tepelene dhe Vlore. (Shtesa 2, Tabela 4, 5 dhe 5/1)


Nenpunesimi shprehet kryesisht me numrin e familjeve bujqesore qe mbeshteten nga shteti me ndihme ekonomike te pjeseshme. Nenpunesimi eshte kryesisht i pranishen ne zonat rurale malore dhe me i theksuar ne verilindje te Shqiperise. Duke mos patur burime te tjera jetese pervec tokes bujqesore, pjesa me e madhe e familjeve e rretheve Diber, Kukes, Tropoje, Shkoder, Mirdite, Mat, jetojne vetem me te ardhurat dhe prodhimet e fermes ne pronesi, e cila eshte e kufizuar ne sasi dhe e nje cilesie te ulet.





Nenpunesimi dhe papunesia e larte eshte e pranishme edhe ne zonat rurale te mbipopulluara nga migracioni i brendshem pas vitit 90. Ne komunat e Kamezes, Paskuqanit, ne rrethin Tirane, ne komunat Katund i ri ne rrethin Durres, pjesa e madhe e popullsisë se afte per pune eshte e papune dhe jeton kryesisht me punesimin e perkohshen ne tregun joformal, ne kufinje e varferise se plote.¹⁷ (Shtesa 2, Tabela 6.)

¹⁶ Ne vitin 1994, niveli i papunesise ne rang kombetar ishte 18%.


¹⁷ Si kufi varferie eshte caktuar ne menyre administrative, 250 % e nivelit baze te pageses se papunesise.





TREGUESIT EKONOMIKE NE PREFEKTUREN E DIBRES




-  Papunesia
-  Punesimi ne sektorin shteteror
-  Punesimi privat jobujqesor
-  Punesimi privat bujqesor





TREGUESIT EKONOMIKE NE PREFEKTUREN E SHKODRES




-  Papunesia
-  Punesimi ne sektorin shteteror
-  Punesimi privat jobujqesor
-  Punesimi privat bujqesor





TREGUESIT EKONOMIKE NE PREFEKTUREN E VLORES



-  Papunesia
-  Punesimi ne sektorin shteteror
-  Punesimi privat jobujqesor
-  Punesimi privat bujqesor


TREGUESIT EKONOMIKE NE PREFEKTUREN E BERATIT



-  Papunesia
-  Punesimi ne sektorin shteteror
-  Punesimi privat jobujqesor
-  Punesimi privat bujqesor


Persa i perket ndarjes se papunesise, ne nivel nacional sipas gjinise, ajo eshte me e larte tek femrat me 21 perqind dhe me e ulte tek meshkujt me 16 perqind. Nivele me te larta papunesie tek femrat kane qytetet Vlore, Tirane, Berat, Kavaje dhe shpjegohet me mbylljen e aktiviteteve te industrise ushqimore, asaj tekstile dhe artizanatit. Ne qytetet Elbasan, Bulqize, Durres, Fier, Skrapar, papunesia ne meshkujt eshte me e larte se mesatarja dhe shpjegohet me mbylljen e ndermarrjeve te industrise se rende dhe minierave. Te dhenat e papunesise ne vite, tregojne se, aktualisht, femrat kane mundesi me te pakta punesimi.

Papunesia ne vite sipas gjinise



Persa i perket moshes se te papuneve, ajo eshte e pranishme tek 60 perqind e grupmoshes 16-34 vjec dhe eshte e lidhur me faktin e mungeses se ekperiences apo te nje profesioni te mirfillte per kete grupmoshe. Grupmosha 16-34 vjec ne qytetin e Vlores perfaqeson 86 perqind e te papuneve te rregjistruar, ne Mat 82 perqind, ne qytetin e Tiranes 66 perqind, ne Puke 65 perqind, ne Shkoder 63 perqind, ne Tropoje 62 perqind , Kucove 60 perqind. (Shtesa 2, Tabela 5)

Papunesia per grupmoshen 16-34 vjec, sipas viteve




Ne vitet e para te tranzicionit, papunesia perfshiu te gjitha profesionet dhe ishte e pandieshme ndaj nivelit aresimor apo moshes. Sipas INSTAT-it¹⁸, ne 1998, 90 perqind e te papuneve te intervistuar kane aresim tetevjecar dhe te mesem dhe vetem 7 perqind ka aresim te larte, ndersa sipas raporteve te Minisitrise se Punes ne 1999, 97 perqind e te papuneve afatgjate te rregjistruar ne zyrat e punes kane aresim tetevjecar dhe te mesem ndersa vetem 3 perqind aresim te larte.

3. PAGAT DHE ECURIA NE VITE.

Paga si nje element i rendesishem i tregut te punes ka pesuar ndryshime te vazhdueshme. Ne vitin 1992, per here te pare, paga lidhet me indeksin e cmimeve te konsumit dhe percaktohet niveli minimal i pages. Gjate 1990-2000, pagat kane pesuar ndryshime. Ne sektorin shtetedor rritje reale me te madhe paga e ka patur ne vitin 1994 me +26perqind dhe me te ulet ne ne 1997 me -17perqind. Ne vitin 1999 paga pesoi rritje reale me 10 perqind.

Egziston nje disnivel i larte midis punes se shperblyer ne sektorin privat dhe ate shtetedor. Pamvaresiht mungeses se te dhenave te plota raporti midis pagave ne sektorin privat dhe ate shtetedor, qendrojne ne raportin 1 me 3. Sipas INSTAT-it ne vitin 1999, prodhimi i brendshem i realizuar nga nje i punesuar ishte 41,664, nderhohe qe shperblimi mesatar per nje te punesuar ne sektorin shtetedor ishte vetem 30 perqind e tij.

Paga reale ne vite



C. MIREQENIA SOCIALE

1. ARSIMI

Administrimi i Sistemit Arsimor ne Shqiperi. Organizimi administrativ i sistemit arsimor ne Shqiperi perfshin disa nivele institucionale¹⁹. **Niveli Qendror** perfshin organet legjislative dhe ekzekutive si dhe institucionet kombetare. Keto jane Ministria e Arsimit dhe institucionet ne varesi te saj, si Instituti i Studimeve Pedagogjike, Shtepia Botuese e Librit Shkollor, etj. Parlamenti dhe Keshilli Ministrave percakton politikat shtetore te arsimit laik si dhe merren nismat legjislative ndersa Ministria e Arsimit vendos kriteret per hapjen e institucioneve shkollore, ngarkesa e trupes pedagogjike, numri i nxenesve neper klasa, kriteret per kualifikimin e mesuesve dhe kriteret per dhenien e diplomave. (Shtesa 2, Tabela 7)

Niveli Lokal, perfaqsohet nga Drejtorite Arsimore ne nivel rrethi, si dhe nga Sektoret Arsimor ne nivel Bashkie dhe Komune. Drejtorite Arsimore jane ne varesi nga Ministria e Arsimit dhe

¹⁸ Anketim mbi nivelin e jeteses ne Tetor 1998, «Tregu i Punes ne Shqiperi ».

¹⁹ Raporti Bankes Boterore

kane si kompetence emerimin e mesuesve, trajnimit e tyre, si dhe planifikimin dhe kontrollin e investimeve ne arsim. Sektoret e Arsimit si struktura lokale jane te pavarura nga Ministria e Arsimit. Ato pergjigjen per mirembajtjen e ndertesave te shkolles dhe administrimin e brendshen te saj.

Niveli Shkolles, perfaqsohet nga Drejtoria e Shkolles, Keshilli Pedagogjik, Keshillat e Prinderve si dhe Bordi i Shkolles.

Struktura e Arsimit Parauniversitar²⁰ **perفشin nivelin e pare**, qe eshte ai parashkollor, (me kopshtet dhe cerdhet), **nivelin e dyte**, qe shte ai tetevjecar i detyrueshem, I organizuar ne dy cikle dhe **nivelin e trete** te arsimit ne Shqiperi, qe eshte ai i mesem dhe eshte i organizuar ne te mesem te pergjithshem dhe te mesem profesional. **Niveli i fundit** eshte arsimi i larte. (Shtesa 2, Tabela 9, 10, 11, 12 and 13)

Tabela 8 Tregues te aresimit para-universitar gjate vitit shkollor 1999-2000

Emertimi	Gjithsej	Nivelet e arsimit					
		Para shkollor	%	8 vjecar	%	I mesem	%
Nr. Nxenesve	727,275	80,337	11	543,967	75	102,971	14
Pa shkeputje	12,243	-	-	-	-	12,243	-
Nr. institucioneve	4,327	2,111	49	1,828	42	388	9
Nr. i mesuesve	38,607	3,806	10	29,055	75	5,746	15

Shkollat Private. Duke filluar qe nga viti 1991 e ne vazhdim, ne Shqiperi jane hapur kopshte dhe shkolla private te nivelit 8-vjecar dhe te mesem. Numri i institucioneve private te nivelit parashkollor, tetevjecar dhe te mesem ne ne te gjithe vendin ne vitin 2000, arrin ne 120.

Financimi I sistemit aresimor ne shkalle vendi, behet nga qeveria nepermjet pushtetit lokal. Per arsimin miratohet cdo vit nje buxhet i caktuar, faza e pare e hartimit te te cilit kryhet neper rrethe nga organet e pushtetit lokal. Komunitat dhe bashkia e rrethit, ne bashkepunim me drejtorine arsimore planifikojne shpenzimet per vitin e ardhshem. Projekt-buxheti paraqitet ne Ministrine e Financave. Mbasi behen modifikimet e duhura nga kjo ministri, projekt-buxheti i kalon Keshillit te Ministrave, ndersa miratimi perfundimtar behet ne parlament.

Tabela 8.1 Fondi buxhetor per sistemin aresimor sipas viteve

Emertimi	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Buxheti i sistemit aresimor (ne milion leke)	6,135	8,461	10,310	11,197	13,692	NE
Fondi i aresimit si perqind ndaj shpenzimeve te buxhetit	10	11	12	11	10	NE
Fondi i aresimit si perqind ndaj PBB-se	3.3	3.7	3.7	3.3	2.9	NE

²⁰ Arsimit ne Shqiperi "Dosje Kombetare" 1997

PROBLEMET KRYESORE NE ARSIM

Administrimi dhe financimi: Administrimi I arsimit nepermjet skemes vertikale ekzistuese eshte teper i nderlikuar. Ai krijon nje lloj ndervaresie ndermjet strukturave pjesmarrese, duke ndikuar negativisht si ne vendimarrje ashtu dhe ne shperndarjen e pergjegjesive. Nga intervistat e bera me specialiste te arsimit ne Bashki e Komuna shihet si domosdoshmeri, berja e nje reforme institucionale te mirefillte, qe ti jape kompetenca te plota vendimarrrese strukturave te pushtetit lokal qe merren me arsimin.

Pavaresisht se pjesmarrja e strukturave lokale ne hartimin e buxhetit per arsimin eshte rritur ndjeshem keto vite, perseri sistemi i financimit eshte shume i centralizuar dhe statik. Si pasoje e ketij centralizimi veprimet financiare shpesh bllokohen nga procedura burokratike. Nisur nga fakti se buxheti vjetor per arsimin hartohet cdo fillim viti, propozimet e reja per shpenzime shtese gjate vitit shkollor nuk gjejne zbatim. Si rrjedhoje eshte e rendesishme qe strukturave lokale qe merren me arsimin tu lihet nje fond i caktuar shtese, i cili te menaxhohet nga vete ato.

Braktisja e shkolles eshte sot problemi kryesor I sistemit tone aresimor. Arsytet e perhapjes se ketij fenomeni jane te ndryshme per nivele te ndryshme shkollore. Shkaku i pare per braktisjen dhe frekuentimin e uljet ne nivelin para-shkollor eshte mbyllja e mjaft institucioneve gjate tranzicionit, si pasoje e shkaterrimit te tyre apo zaptimit me force nga banoret ne te gjitha zonat e Shqiperise. Rritja e papunesise per grate ndikoi, gjithashtu, ne uljen e nevojës dhe kerkeses per arsimin parashkollor.

Faktori kryesor qe ka ndikuar ne uljen e frekuentimit dhe ne braktisjen e shkolles ne nivelin tetevjecar eshte mungesa e te ardhurave te mjaftueshme te familjeve per te mbajtur femijet ne shkollë dhe per te perballuar ato shpenzime qe jane te detyrueshme. I rendesishem eshte edhe faktori I perfshirjes se femijeve me punet e bujqesise. Distancat e largeta te shkolles nga shtepite, dhe ne menyre te vecante, ne zonat malore ndikon negativisht ne frekuentimin e shkolles. Braktisja e shkolles tetevjecare eshte me problematike ²¹ ne Peqin(9 perqind),Diber (7 perqind), ne Kukes (7 perqind), Librazhd dhe Kavaje (5 perqind). Megjithate ne nivel kombetar, braktisja e shkolles ka rene nga nga 3 perqind ne 1999 ne 2,6 perqind ne 2000. Kjo rritje ne frekuentim, i dedikohet nje pune me te mire te mesuesve, rregullimin e godinave te shkolles, rregjistrimin e rregullt te femijeve ne zonat ku ato jetojne, rritjes se sigurise ne shkolla, zgjidhjes se problemit te transportit per disa zona, etj. (Shtesa 2, Tabela 10)

Frekuentimi ne nivelin e mesem eshte ulur kryesisht ne shkollat e mesme profesionale, si pasoje e mbylljes se nje numri te madh te tyre. Shumica e nxenesve qe u larguan nga shkollat profesionale e braktisen shkollen fare, cka shpjegon dhe renien ne pergjithesi te numrit te nxenesve ne shkollat e mesme. Nga 79 perqind qe frekuentonin te mesmen ne 1990 ne 41 perqind ne 1998. Ky fenomen ka qene me tipik ne fshat ku kane qene dhe me te shumta shkollat profesionale (bujqesore). (Shtesa 2, Tabela 13)

Infrastruktura Aresimore dhe Investimet te realizuara nga shteti shqiptar dhe nga organizmat nderkombetare ne vlere absolute jane ende te ulta ne raport me problematiken(megjithese vitin e fundit Qeveria Shqiptare planifikoi 12 perqind te buxhetit). Organizmat nderkombetare kane vleresuar me prioritet investimin ne te. Prioriteti i ketyre

²¹ Sektori i Statistikes Ministria e Aresimit, Tetor 2000

investimeve dy vitet e fundit ka qene infrastruktura e jashtme e shkollave si ndertimi i shkollave te reja dhe rikonstruktimin e atyre ekzistuese (fasadat e ndertesave, cati, mure rrethues, ambiente te reja shtese per klasa). Si rezultat i gjithe kesaj pune jane ndertuar 50 shkolla te reja, jane rindertuar 350 te tjera, ku 280 nga keto nga donatoret e huaj. Si pasoje e ketyre investimeve eshte rritur numri i nxenesve ne shkollat e mesme ne rang republike me 800 nxenes dhe ne shkollat e larta me 200 studente me shume ne raport me vitin e kaluar.

Sipas raportit te sektorit te statistikes ne Ministrise se Aresimit lidhur me investimet qe ka bere qeveria shqiptare nga viti 1997-2000 ne arsim kemi keto te dhena: jane ndertuar 3 kopshte me 24 grupe, 28 shkolla fillore me 91 klasa, 73 shkolla 8 vjecare me 627 klasa, 5 shkolla te mesme me 74 klasa. Universitetit te Gjirokastres iu shtua kapaciteti me 24 mjedise mesimore, Fakulteti i ri ekonomik ne Tirane me nje fond prej 1 milion dollar perfundon ne vitin 2001. Po ashtu jane bere edhe shtese mjedisesh ne universitetin e Shkodres. Jane rindertuar 57 kopshte me 259 grupe, 33 shkolla fillore me 109 klasa, 318 shkolla 8-vjecare me 3468 klasa, dhe 144 shkolla te mesme me 2027 klasa. Jane rikonstruktuar 33 objekte universitare, 23 konvikte te shkollave te mesme me 368 dhoma fjetje dhe mjedise te tjera ndihmese.

Tendenca e investimeve ne arsim per vitin e ardhshem ka te beje me plotesimin me pajisje didaktike te shkollave ne te gjitha nivelet, duke parashikuar qe ne vitin 2003 nevojat paresore lidhur me infrastrukturen e shkollave tona do te gjejne zgjidhje. Buxheti i shtetit per arsimin ne vitin qe vjen llogaritet te jete serisht rreth 12 perqind.

Mbingarkesa/Nenngarkesa e shkolles dhe e klasave po demton efektivitetin e mesimdhënies. Migrimi masiv dhe i pakontrolluar, kryesisht ne rrethet Tirane (Kamez, Paskuqan) dhe Durres (Katund i Ri, Shijak, Sukth) po perball rritjen progresive te numrit te nxenesve me mungesen e hapësirave dhe mjediseve shkollore ne keto zona. Mbipopullimi me nxenes i klasave ne nivelin 8-vjecar eshte me i dukshem ne klasat e para dhe te pesta ku arrijne edhe 55 nxenes per klase. Ne shume shkolla te Tiranës dhe Durresit mesimi ne nivelin 8-vjecar behet me dy turne, paradite dhe mbasdite. Nje panorame e ndryshme nga kjo shfaqet ne zonat rurale te vendit, ku si pasoje e zhvendosjeve te popullates dhjete vitet e fundit nga Malesite e Kukedit, Shkodres, Peshkopise, Librazhdit, Miredites, nje numer i madh shkollash jane mbyllur. Edhe shkollat egzistuese ne keto zona kane nje numer shume te vogel nxenesish qe arrin deri ne 5 nxenes per klase ne nivelin 8-vjecar si ²² ne komunat e Ostrenit (Bulqize) Gradecit (Malesi e Madhe) Shosh (Shkoder) Topojan (Kukes) etj. Ne keto komuna jane krijuar dhe funksionojne klasat e bashkuara qe konsistojne ne bashkimin e nxenesve te niveleve te ndryshme, ne te njejtat ambiente dhe me te njejtet mesues, egje e cila nuk eshte nje zgjidhje efektive. Numri i vogel i nxenesve per klase deri ne 5-6 nxenes eshte tipik edhe per shkollat ne zonat ku jane vendosur komunitetet e etnive te tjera. Shkolla te tilla ka ne Veri te vendit (etni Malazeze), ne Lindje ne zonen e Gollobordes (etni Maqedonase) ne fshatrat e Sarandes, Gjirokastres, (etni greke).

Kualifikimi i Mesuesve dhe Transporti deri ne shkollat: Zonat qe paraqesin me shume probleme persa i perket numrit te mesuesve pa arsimin perkates jane Dibra me 12 perqind te mesuesve, Elbasani me 13 perqind, Gramshi me 12 perqind, Hasi me 12 perqind dhe Kukesi me 19 perqind. Mesuesit ne keto zona jane pa arsimin perkates ose me arsimin perkates por te nje profili tjetër. Mungesa e mesuesve te kualifikuar ne keto zona eshte pasoje e disa faktoreve ku me te rendesishmit jane pagesa e ulet, mungesa e transportit emigrimi i mesuesve te kualifikuar drejt Tiranës, Durresit, Shkodres, Lezhes, etj.

²² Informacioni i marre nga intervistat me drejtuesit e arsimit ne Bashki dhe Komuna , Shtator-Tetor 2000

Nje tjetër problem shqetesues për shkollën është edhe transporti i mesuesve dhe nxenesve. Zonat me problematike përsa i përket transportit të mesuesve dhe nxenesve janë komunat e Shosh-Shllak (Shkoder), Kastrat-Dedaj (Malesi e Madhe), Kraste (Bulqize) etj. Në të gjitha shkollat në zonat malore ku transporti mungon, ka probleme me frekuentimin e nxenesve dhe me numrin e mesuesve të kualifikuar. Për të zbutur problemin e transportit, aktualisht po funksionojnë shkollat rajonale. Këto shkolla duke qenë në zona ku kryqezohen rrugët nacionale e kanë të zgjidhur problemin e transportit, dhe mund të bëhet e mundur që mesuesit që punojnë në këto shkolla të jenë të gjithë me arsimin përkatës. (Shtesa 2, Tabela 11, 12 dhe 13)

2. SHERBIMI SHENDETSOR

Administrimi i sistemit shëndetësor: Sistemi shëndetësor përfaqësohet nga institucionet qendrore që janë Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, Instituti i Shëndetit Publik, dhe 36 drejtori të shërbimit shëndetësor publik në rreth. Në nivel lokal sistemi shëndetësor që ofron direkt shërbime shëndetësore përfaqësohet nga 2,168 qendra shëndetësore përsor (poliklinika, qendra shëndetësore dhe ambulanca), 51 spitale rrethesh, 1,562 konsultore të nënës, 1,615 konsultore për fëmijë, 92 qendra të planifikimit familiar dhe 743 farmaci.

Kujdesi shëndetësor primar dhe parandalues realizohet nëpërmjet qendrave shëndetësore pa shtretër të cilat përbejnë edhe përbejnë edhe sektorin më të rëndësishëm të sistemit publik shëndetësor. Poliklinikat dhe qendrat shëndetësore janë të vendosura kryesisht në qytete dhe një pjesë e poliklinikave ofrojnë mbulime me shërbime të specializuara për banorët e një rrethi. Në zonat rurale sistemi shëndetësor përfaqësohet nga ambulanca me të pakten një infermier ose mami.

Shërbimi shëndetësor përsor, i cili përfaqëson rrjetin e Qendrave Shëndetësore (QSH) ofron shërbime imunizimi, diagnostifikim të sëmundjeve respiratore, kujdes antenatal (për lindjen), planifikim familjar dhe monitorim të rritjes së fëmijëve. Shërbimi shëndetësor përsor është i shpërndarë sipas normave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Këto norma përcaktojnë që në zonat rurale malore të ketë 1 QSH për çdo 2000 banorë, në zonat fushore kodrinore 1 QSH për 4000-8000 banorë dhe për zonat urbane 1 QSH për 10000-15000 banorë dhe quhen poliklinika. Në zonat rurale QSH shërben si qendër për të gjitha ambulancat e fshtave të një komune (e theksojmë që ambulancat gjenden vetëm në fshat). Në Shqipëri operojnë në nivel komunash 596 QSH dhe 1,572 ambulanca. (Shtesa 2 Tabela 15)

Shërbimi shëndetësor dytesor përfaqësohet nga 51 spitale të vendosura në qendrat e çdo rrethi. Këto të fundit kanë në stafin e tyre me shumë mjekë të specializuar, por jo të gjithë ofrojnë shërbime të veçanta për gratë e fëmijët me repartë të specialiste përkatës. Gjate 10 vitet e fundit janë mbyllur 40 spitale të vegjël kryesisht në zonat rurale. (Shtesa 2, Tabela 15, 16)

Pjesa më e madhe e shërbimeve dentare dhe farmaceutik janë privatizuar. Një shkallë të lartë privatizimi nuk vërehet për shërbimin përsor dhe dytesor, megjithatë egzistencën e klinikave private. Qendër e manaxhimit të fondeve për shëndetësinë si nga buxheti i shtetit ashtu edhe nga kontributet e Institutit të Sigurimeve Shëndetësore, është Drejtoria e Shëndetit Publik në rreth. Instituti i Sigurimeve Shëndetësore është krijuar në 1995 dhe mbulon një pjesë të shpenzimeve për pagat e mjekëve të përgjithshëm dhe farmacistëve. Ky institut pjesën më të madhe të të ardhurave e siguron nga kontributet punonjësit e sistemit buxhetor duke që në këto mënyrë eficient vetëm në masën 40 përqind.

PROBLEMET KRYESORE NE SHENDETSI SIPAS SHERBIMEVE QE KY SISTEM OFRON

Vaksinimi: Imunizimi eshte sherbimi me i sukseshem qe ka depertuar pothuajse ne te gjitha zonat e vendit. Shume nga qendrat shendetsore furnizohen rregullisht me vaksina e shiringa deri ne masen 72 perqind. Nga te dhenat zyrtare rezulton se mundesite e mbulimit te vaksinimeve, ne shkalle vendi, jane 93 perqind. Nuk egziston ndonje diference e theksuar ndermjet qyteteve te medha dhe zonave te thella.


Sherbimi i kujdesit nene-femije:Te dhenat per sherbimin e paralindjes tregojne se ky sherbim eshte i mundeshem te grate shtatezena, pavaresisht nga zona e rezidences se tyre. Shumica e grave shtatezena (86 perqind) vizitohen nga stafi shendetsor gjate shtatezanise 3 here e me shume. Per lindjet shumica e grave I referohen shtepive te lindjes dhe materniteteve. Por ne zonat rurale verehet nje numer i konsiderueshem i lindjeve behen ne shtepi. Ne komunen e Sukthit rapotohet se nje nder pese lindje behet ne shtepi. Ne shkalle vendi egzistojne 184 shtepi te lindjes e maternitete dhe 1,562 konsultore per grate. Kujdesi i paralindjes sigurohet ne masen 100 perqind ne Kavaje, 78 perqind ne Vlore, 77 perqind ne Fier dhe 75 perqind ne Gjirokaster. Kurse lindjet e asistua ne shtepi sigurohen ne masen 33 perqind Tepelena, 27 perqind ne Durres, 23 perqind ne Lushnje, 11 perqind ne Kavaje, 10 perqind ne Vlore dhe 0 perqind ne Puke, Mallakaster e Has, etj. (Nuk ekzistojne te dhena per kete sherbim per te gjitha Shqiperine). Ka nje mungese te madhe te asistences se lindjeve ne shtepi , qe vjen kryesisht nga mungesa e transportit dhe largesia gjeografike, gje qe shton rrezikun e vdekshmerise memesore e foshnjore ne keto lindje.

Vdekshmeria foshnjore verehen sidomos ne komunat Balldre, Shengjin, Tarovice ne rrethin e Lezhes. Si shkak kryesor konsiderohet zbritja e ketyre familjeve nga zonat malore dhe se ato nuk jane te vendosur per te banuar ne shtepi normale. Po ashtu ky mortalitet eshte prezent ne rrethet Diber (45 lindje per mije), Bulqize (38 lindje per mije), Kucove (37 per mije) dhe Malesi e Madhe (29 per mije). Ndersa mortaliteti amnor eshte me i ndjeshem ne rajonet e Elbasanit dhe Matit me 2-3 vdekje ne vit (Shtese 2, Tabela 14).

Planifikimi familjar : Planifikimi familjar eshte i siguruar jo i plote ne QSH. Egzistojne 92 qendra te planifikimit familjar ne shkalle vendi. Ky shebim ofrohet ne masen 100 perqind te QSH te rretheve Kavaje e Kruje qe paraqesin edhe nivelet me te larta ne shkalle vendi. Nje shembull i mbulimit ne zonat e tjera eshte si vijon: 63 perqind ne Elbasan, 30 perqind te QSH ne Kurbin, 23 perqind ne Vlore, 11 perqind ne Tepelene dhe 0 perqind ne Gjirokaster. Sic tregojne statistikat ekziston nje shperndarje e pabarabarte te ketij sherbimi. Nje problem tjetër qe e ben me pak efikas kete sherbim eshte mosshperndarja e rregullt e kontrceptiveve. Ne Elbasan ku ofrohet ky shebim ne masen 63 perqind, shperndarja e kontrceptiveve eshte bere ne masen 28 perqind, ne Fier 18 perqind, etj (Te dhenat jane te kufizuara). Kjo ben qe edhe aty ku funksionon ky sherbim te jete me teper propagandues se sa ndihmes konkret. Zgjidhja me e pershtatshme per te realizuar kete planifikim mbetet aborti.

Manaxhimi i infeksioneve te organeve te frymemarrjes dhe te tjera: Menaxhimi i infeksioneve respiratore eshte i siguruar ne masen 100 perqind te QSH ne Kurbin e Gjirokaster, 70 perqind Shkodra, 68 perqind Librazhdi etj. Ky sherbim eshte siguruar pavaresisht nga mungesa e madhe e udhezuesve diagnostike e terapeutike lidhur me IRA dhe perqindjes se ulet te personelit te trajtuar nga kjo qender e infeksioneve respiratore. Persa i perket manaxhimit te rasteve me diare eshte i ndryshem ne zona te ndryshme. Duhet shtuar edhe mungesat e medha qe konstatohen ne furnizimin me antibiotike te rretheve. Ujtit te pijshem i cili konsiderohet nje nga shkaqet kryesore per infeksionet e tjera konsiderohet 81 perqind ne Durres, 62 perqind ne Lushnje, 60 perqind ne Kruje dhe 50 perqind ne Kurbin (te

NIVELI I VDEKSHMERISE FOSHJORE



dhenat jane te kufizuara). Nje problem i identifikuar mbi higjenen ishte se punonjesit e shendetit nuk jane gjithmone te mbrojtur siç duhet nga infeksionet. Disa punonjes laboratoresh ne Durres nuk kane as doreza per te veshur.

Sherbimi i shteses ushqimore: Kequshqyerja eshte permendur si nje semundje qe prek nje pjese te konsiderueshme te femijeve ne Shqiperi, sidomos ne zonat rurale. Ka nje deficit te konsiderueshem persa i perket sigurimit te shtesave ushqimore ne vitamina A, D, e jod prandaj verehen raste ne rritje te rakitit e te strumave (teroiideve) te cilat shkaktojne nje problem serioz per te ardhmen e femijeve dhe duket se pothuajse asgje nuk po behet ne kete moment per t'i parandaluar ato. Niveli me i larte i ketij sherbimi arrin ne masen 21 perqind ne rrethin e Krujes ndersa rrethe te tjera e kane shume te ulet kete sherbim. Ne Durres 9 perqind, ne Elbasan 6 perqind, Fier 5 perqind. Ne Fier 9 nga 81 sherbime shendetsore sigurojne shtesa ushqimore. Por egzistojne edhe rrethe si Devolli, Malesia e Madhe, Hasi, Kavaja, Kurbini qe nuk e sigurojne fare kete sherbim. Ne Elbasan konfirmohen te regjistruara 794 raste me strume, ne nje kohe qe vetem 2 sherbime nga 32 u furnizuan me jod. Ky sherbim ka nevojte per fuqizim te menjehershme ne te gjitha QSH te rretheve. Nga studimi i kryer prej INSTAT rezulton se mosha me e cenuar nga kequshqyerja ishte grupmosha 1-2 vjeç. Kjo verehej sidomos te femijet e nenave me aresim fillor e tetevjeçar. (Te dhenat jane te kufizuara)


Monitorimi i rritjes: Monitorimi i rritjes qe kryhet ne konsultoret e femijeve paraqitet si nje sherbim i ofruar mire prej tyre .Ne shkalle vendi egzistojne 1,615 konsultore per femije. Ky monitorim kryhet ne 95 perqind te QSH ne Vlore, 85 perqind ne Tirane dhe 82 perqind ne Durres. Por nuk ndodh keshtu ne Gjirokaster ku ky sherbim ofrohet ne masen 38 perqind te QSH, apo ne Elbasan 23 perqind, per te arritur ne rrethe si Tepelena, Tropoja e Bulqiza me rreth 0-5 perqind. Konstatohet nje diference e larte mes rretheve.

Sherbimi dentar e farmaceutik: Nje pjese e konsiderueshme e ketij sherbimi eshte privatizuar dhe ka shume pak klinika dentare te atashuara prane QSH dhe disa prane shkollave, qe financohen akoma nga shteti. Kete sherbim e ofrojne ne rruge shtetore 44 perqind e QSH ne Kavaje, 13 perqind ne Sarande. Ne rrethe si Delvina, Kurbini e Tepelena QSH nuk e ofrojne fare kete sherbim. Kryesisht sherbimi dentar realizohet nga privatet. Per tu vene ne dukje eshte, se ne disa QSH egzistojne paisjet per kete sherbim te cilat ishin prone e shtetit por mungon dentisti, i cili preferon te punoje privat. Ne zonat e thella Ministria e Shendetesise zoteron akoma nje pjese te ketyre sherbimeve.

Ne shkalle vendi funksionojne 743 farmaci. Edhe ky sektor eshte kryesisht i privatizuar por ne zonat e thella ky sherbim mungon. Rast tipik eshte rrethi i Lezhes ku ne komunat e Zejmenit e Kashnjetit, ne Kavaje ne komunat Helmas e Sineballaj, ky sherbim mungon totalisht. Duke qene se burimet e ilaçeve jane private, pacienti nuk ka shanse qe te marre ilaçe pa pagese. Buxheti i sherbimeve shendetsore te komunitetit eshte shume i vogel dhe rralle e perfshin kete aktivitet.

Personeli shendetsor: Egziston nje disproporcion midis trajnimit dhe kualifikimit te punonjesve qe trajtojne semundjeve te ndyshme dhe kritetere te vendit punes. Per trajtimin e infeksioneve respiratore ne Kukes jane trajnuar vetem 70 perqind e personelit qe kryen kete pune nga qendra e IRA-s, ne Fier 23 perqind, ne Elbasan 16 perqind. Persa i perket punonjesve shendetsor te trajnuar nga KNF (kujdesi per nenat dhe femijen) jane trajnuar 50 perqind e atyre qe e kryejne kete sherbim ne Shkoder, 8 perqind ne Vlore, 0 perqind ne Peqin. Edhe niveli i sherbimit pediatrik e obstetrik paraqitet me probleme per shkak te mungeses se mjekëve te specializuar p.sh pediater ne Lushnje, Laç, Malesi e Madhe, Peqin me obstetere-gjinekolog ne Bulqize, Delvine, Devoll. Disa specialiste mjeksore jane larguar ne emigracion. (Shtesa 2, Tabela 17)

SHPERNDARJA E PERSONELIT MJEK PER 10'000 BANORE



Personeli është pak i motivuar për punë për shkak të pagave të ulta ose kushteve të vështira të punës dhe vazhdojnë të punojnë ose sepse nuk kanë mundësi tjetër jetese ose për pasion. Madje verehej një mos stimulim i atyre mjekëve të cilët jo vetëm punonin në kushte të vështira por edhe në zona të thella malore. Megjithatë duket se shërbimi i personelit dhe shpërndarja e tij është me tepër një mungesë manaxhimi apo politikash sesa mungesë burimesh njerzore. Kur punonjësi i shëndetit punon në zona rurale ai ndjehet i braktisur, për shkak të furnizimeve jo të rregullta dhe pamundësisë për të përmirësuar njohuritë me trajnime të ndryshme. (Shtesa 2, Tabela 17)

Financimi dhe investimet e bera në Qendrat Mjekësore : Një pjesë e mirë e këtyre qendrave paraqiten akoma të amortizuara dhe jo efikente me gjithë përpjekjet për nderhyrje nga shteti dhe nga donatorët e tjerë e OJQ. (Shtesa 2, Tabela 18 dhe 19). QSH u bënë shpesh gjatë këtyre viteve tranzicioni objekt i okupimit apo i shkatërrimit sidomos në zonën verilindore. Për këtë mosfunksionim një shkak tjetër është edhe mungesa e ujit dhe e energjisë elektrike.

Pjesa më e madhe e QSH dhe të gjithë shtetet identifikuan shtetin si përgjegjës për buxhetin, që vendos për fondet dhe llojin e shërbimit që ofrohen. Ky është një proces tepër i centralizuar dhe lejimi i autoriteteve lokale për të qenë përgjegjës në veteqeverisjen e këtyre institucioneve ndoshta do të rriste cilësinë e shërbimeve të siguruar sidomos në QSH.

Shumica e QSH paraqiten të mangëta në paisje me gjithë investimet e bera. Doktorët dhe infermierët e përshkruajnë shërbimin që ofrojnë “ një stetoskop dhe kater mure”, shpesh pa ujë dhe energji. Siguruesit lokale të shëndetit raportojnë mungesa të mikroskopeve për laboratore, mungesa paisjesh për egzaminime fizike si aparate tensioni, peshore bebesh dhe ilaçe të urgjencës. Kështu që doktorët shpesh përdornin sytë dhe duart për të vlersuar dhe diagnostikuar pacientet. Të gjitha komunat kanë pothuajse të njëjtat probleme.

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit të shtetit për shëndetsinë shifrat në tre vitet e fundit paraqiten si vijon: Në 1998 7,985 milion leke, në 1999 12,228 milion lek dhe në 2000 është realizuar deri në fundin e 6 mujorit të parë një buxhet prej 342 milion. (të dhëna të MSH). Fondi vjetor për shëndetsinë përben 6-7 përqind të shpenzimeve buxhetore, gjithsej. Një fond të konsiderueshëm shpenzimesh përmbajne edhe projektet e organizatave të ndryshme për shëndetsinë. (Shtesa 2 Tabela 18 dhe 19)

3. MBROJTJA SHOQERORE

Deri para viteve '90, papunesia nuk egzistonte (te pakten zyrtarisht) dhe koncepti i vulnerabilitetit si mohim dhe përjashtim nga të drejta themelore njerzore, nuk kishte vlerë as vlerë praktike dhe as institucionale. Kjo shprehej me mungesën e institucioneve dhe instrumentave për të luftuar vulnerabilitetin dhe përjashtimin social. Në vitet 90, Shqipëria hyri në rrugën e tranzicionit pa një bazë në fushën e mbrojtjes shoqerore.

A. Ndihma ekonomike

Skema e ndihmes ekonomike u krijua në vitin 1993 mbi një boshllëk ligjor dhe institucional. Në këtë vit rreth 150,000 individë të papunë nuk përfitonin pagesë papunesie ndërsa për 240,000 të tjerë kjo pagesë ishte drejtë fundit. Paqja sociale ishte në rrezik pasi shumë shpejt një numër i konsiderueshëm familjesh do të gjendeshin pa asnjë mjet jetese.²³ Programi i ndihmes ekonomike, i cili bazohet në testimin e mjeteve të jetesës, mbështet financiarisht çdo

²³ QKShSS, Ndihma Ekonomike dhe Përkujdesi Social në Shqipëri, Maj 1999

muaj, familjet shqiptare pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme nga burime te formuara ne treg ose jashte tij.

Programi administrohet nepermjet nje rrjeti lokal seksionesh te Ndhimes ekonomike te shperndara ne 374 komunat dhe bashkite dhe financohet plotesisht nga buxheti shtetit. Fondi i ndihmes ekonomike transferohet ne pushtetin lokal ne formen e grantit 2 mujor dhe kjo e fundit ka pergjegjesine dhe te drejten e shperndarjes e tij deri tek familja e varfer e komunes/bashkise. Niveli i pageses se ndihmes ekonomike kondicionohet nga numri, moshja dhe aftesia per pune e anetareve te familjes pretenduese, por ne cdo rast niveli maksimal i ndihmes ekonomike mujore, nuk mund te jete me i madh se 250 perqind i te ardhurave qe gjenerohen nga pagesa baze e papunesise.²⁴

Ne nivel lokal aktualisht punojne 980 administratore sociale ndersa ne ate qendror 125 punonjes²⁵. Ndryshimet politike, kane bere qe keta nenpunes te jene ne menyre te vazhdueshme objekt i levizjeve. Nga 1993 e deri me sot, administrata lokale te jete nderruar tre here dhe ajo qendrore dy here. Ne kushtet e mungeses se trainimeve profesionale qe nga viti 1996, dhe shkeljes se kushteve te punesimit, niveli profesional i kesaj administrate eshte ne ulje dhe me ndikim negativ tek reduktimi i varferise. Ne nivel lokal, pothuajse mungon bashkepunimi midis zyrave te ndihmes ekonomike dhe te sherbimeve te punesimit. Nuk ka ende zgjidhje afatgjata per ri-integrimin e te varferve nepermjet punesimit apo formimit profesional.

Problemet e sistemit

Pamvaresisht faktit se programi i ndihmes ekonomike eshte i miretargetuar²⁶, analiza e informacionit marre nga nenpunesit lokale te ndihmes ekonomike tregon se brenda sistemit egzistojne probleme.

Trajtimi ne menyre te barabarte i familjeve me probleme ekonomike dhe sociale te ndryshme. Megjithese se masa mujore e ndihmes ekonomike percaktohet ligjerisht nga konditat reale sociale dhe ekonomike te cdo familjeje pretenduese, diferencimi aktual bazohet kryesisht ne numrin e anetareve te familjes dhe jo ne nevojat.

Masa mujore e ndihmes ekonomike teper e ulet dhe e pabazuar ne minimumin jetik, nuk e ndihmon familjen per te mbijetuar. Pagesa mujore aktuale e ndihmes ekonomike eshte e barabarte me 2,532 lek ose me 18 USD. Kjo pagese preket jo vetem nga shkurtimeve te vazhdueshme te fondeve buxhetore apo nga niveli i inflacionit, por edhe nga mungesa e informacionit zyrtar ne nivel lokal mbi nivelin e jeteses.

Mardhenia nivel qendror-lokal. Shperndarja e granteve te ndihmes ekonomike nga niveli qendror ne ate lokal bazohet ne nje sistem treguesish te cilet aktualisht nuk jane te disponueshem ose jo perfaqshues per identikimin e zonave me te varfera.

Tabela 20 Ndhima ekonomike ne vite (ne leke dhe si perqind ndaj PBB-se),

VITET	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Familje perfituese te ndihmes ekonomike (ne 000)	155	153	145	141	150	150	149

²⁴ QKShSS, Ndhima Ekonomike dhe Perkuajdesi Social ne Shqiperi, Maj 1999

²⁵ QKShSS, Ndhima Ekonomike dhe Perkuajdesi Social ne Shqiperi, Maj 1999

²⁶ Harold Alderman, Poverty Assesment in Albania 1997

Buxheti vjetor I ndihmes ekonomike (0000 mije leke)	1,710	3,477	3,401	3,054	3,127	4,817	4,529
Buxheti vjetor i ndihmes ekonomike ne perqind ndaj PPB –se.		2.6	1.5	1.1	1.3	1.4	0.9
Pagesa mesatare mujore familje (ne leke)	1,839	1,888	1,951	1,804	1,742	2,672	2,532

B. Perkujdesi Shoqeror

Perkujdesi shoqeror perbehet nga programi I mbeshtetjes dhe integritimit te individeve te paafte si edhe programi per mbrojtjen e femijeve jetime dhe te moshurarve te vetmuar.

Programi I mbeshtetjes dhe integritimit te individeve te paafte aplikon shenien e ndihmes ne para ne formen e pageses se paaftesise dhe kujdestarise, si edhe dhenien e ndihmes ne sherbime ne formen e rehabilitimi ne qendrat e zhvillimit apo shkollat speciale.

Programi i pageses se paaftesise administrohet nga Administrata e Pergjitheshme e Ndhimes dhe e Perkujdesit Shoqeror²⁷ nepermjet zyrave dhe seksioneve te ndihmes ekonomike ne 374 bashki dhe komuna. Kjo pagese mbeshtet me te ardhura (4,460 lek/muaj) cdo individ te paafte te percaktuar nga Komisioni Ligjor i Caktimit te Aftesise per Pune (KMCAP-i), me konditen qe ky I fundit te mos jete ne mardhenie pune ose te kete te ardhura personale. Gjithashtu, ky program, nje te paafte te grades se rende, I siguron asistencen te vazhdueshme nga nje njeri tjetër I familjes, nepermjet mbeshtetjes me te ardhura mujore te barabarta me 60-70 perqind²⁸ te pages minimale. Statistikat e Qershorit te vitit 2000 tregojne se ne kete skeme jane trajtuar 38,460 individe te paafte dhe 5,400 kujdestare. Programi nxit aresimimin e individeve te paafte, nepermjet aplikimit te pagesave te shkalezuara.

Pervec mbeshtetjes me te ardhura, nje numer i vogel femijesh te paafte perfitojne sherbime rehabilitimi ne qendra rezidenciale dhe ditore²⁹ dhe sherbime aresimimi ne shkollat speciale. (Shtesa 2, Tabela 21)

Perkujdesi Shoqeror per femijet jetime dhe te moshuarit e vetmuar perfshin ofrimin e sherbimeve sociale ne institucione rezidenciale. Para vitit 1993, Institucionet e Perkujdesit shoqeror ndodheshin ne varesine Ministrise se Aresimit dhe Ministrine e Shendetesise nderkohe qe reforma institucionale, jo vetem ben kalimin e tyre nen Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale por edhe i hap rruge iniciativave te aktoreve te tjere si pushteteve lokale, OJQ-ve apo individeve private, ne organizimin dhe menaxhimin e sherbimeve sociale per individe apo grupe ne nevoje. (Shtesa 2, Tabela 21)


Aktualisht sistemi publik i Perkujdesit shoqeror ne Shqiperi ofron sherbime perkujdesi per 585 femije jetime dhe 235 te moshuar te abandonuar nepermjet 15 institucioneve rezidenciale. Gjithashtu nje numer i madh organizatash joqeveritare shqiptare dhe te huaja ofrojne sherbime sociale bashkekohore, kryesisht ne qytetet Shkoder, Tirane, Durres dhe Elbasan.

²⁷ A.P.N.Sh.S-ja , ka te drejten e percaktimit te kriterave perfituese dhe financon 100% te kerkeses se pushtetit lokal per kete pagese bazuar ne dokumentat e cdo individi te leshuar nga KMCAP-i . Eshte ky I fundit qe vlereson dhe percakton te drejten per perfitim.

²⁸ Pagesa e kujdestarit per te verberit eshte 70% e pages minimale, kundrejt 60% per kujdestaret e te paafteve te tjere.

²⁹ Ne fushen e rehabilitimit te individeve handikape funksionojne 7 qendra publike reabilitimi, 6 shkolla publike speciale dhe nje numer qendrash ditore ose shtepi familje qe drejtohen nga OJQ.

SHPERNDARJA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TE PERKUJDESIT SHOQEROR



Probleme te sistemit

Ndersa pagesa e kujdesit shoqeror I ofrohet klientit ne komunen/bashkine ku ai jeton, sherbimet jane te limituara nga pikpamja gjeografike, sepse institucionet qe I sigurojne keto sherbime te jane te perqenderuara kryesisht ne disa qytete kryesore. Egziston nje diference e madhe midis numrit te individeve qe kane nevojte per sherbime perkujdesi dhe atyre qe e perfitojne ate realisht.

Sherbimet institucionale jane dominuese ndaj formave bashkekohore te integrimt duke ndikuar negativisht ne procesin e integrimt te individeve ne nevojte ne jeten normale. Cilesia e sherbime sociale eshte e lidhur me llojin e institucionit (residencial, shtepi familje, qender ditore) dhe lidhjen e tyre me profesionin e punonjesit social, psikologut social, edukatorit social.

Mungesa e njohjes se profesionit te punonjesit social (ne vitin 1996 studentet e pare mbaruan studimet per pune sociale)e kufizon kryerjen e sherbimeve sociale me ndermjetesine e specialisteve te mirfillte.

Per shkak te kostos se larte qe kane sherbimet sociale ne fushen e perkujdesit shoqeror, pushteti qendror apo disa organizata joqeveritare te huaja jane edhe menaxhuesit dhe financuesit e sherbimeve aktuale te perkujdesit shoqeror. OJQ-te shqiptare jane ende te brishta dhe te pafuqishme financiarisht per te ndertuar sherbime sociale ne natyre (social care). Pushtetet lokale gjithashtu nuk kane fonde te mjaftueshme dhe nuk i konsiderojne ende sherbimet sociale si te rendesishme.³⁰

Mungesat dhe dobesite e legjislacionit ne fushen e sherbimeve sociale, ka krijuar kushte per depertimin dhe ushtrimin e profesionit te « bamiresise » te elementeve kriminale te cilet nen petkun e mbrojtjesve te te miturve apo te te pafteve, kane abuzuar mbi ta. Raste te pedofilise nga drejtues sherbimesh per femije jane te njohura edhe ne Shqiperi.

Tabela 22 Buxheti I Perkujdesit shoqeror ne vite (ne vlere dhe si % ndaj PBB-se),

VITET	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Individe perfituese te pagese se paaftesise (ne 000)		16,700	19,000	18,700		
Buxheti vjetor i pageses se paaftesise (ne 0000 mije leke)	2,127	2,756			1,594	1,945

C. Sherbimet e punesimit

Fillimi I sherbimeve te punesimit daton ne vitin 1991 me pagesen e papunesise dhe zgjerohet dhe zhvillohet gjate 1993-1995 me hartimin e ligjit mbi nxitjen e punesimit, Kodin e Punes dhe ndertimin e Sherbimit Kombetar te Punesimit. Aktualisht, sistemi i sherbimeve te punesimit ofron nepermjet 43 Zyrave dhe Agjensive te Punesimit ne rreth, pagesen 1 vjecare te papunesise, keshillim dhe ndermjetesim ne pune, mardheniet e punes dhe formim profesional.

³⁰ NACSS, Ndhma ekonomike dhe Perkujdesi Shoqeror ne Shqiperi, Maj 1999

Sherbimi i pageses se papunesise eshte edhe sherbimi me i ofruar qe nga viti 1991 e deri me sot. Mbi 500,000 te papune, kryesisht te zonave urbane, kane perfituar pagesen e papunesise. Banka Boterore ka financuar zhvillimin e ketyre programeve.

Aktualisht arsimi dhe formimi profesional (AFP) perbehet nga pregatitja profesionale fillestare qe ka te beje me teper me nje sistem arsimor qe varet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences dhe nga pregatitja e metejshme (e vazhdueshme) profesionale e organizuar ne 7 qendra trainuese te varura nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale dhe qendra formimi te ngritura nga private ose nga OJQ te ndryshme.

Ne arsimin profesional nje nderhyrje e rendesishme dhe e domosdoshme ishte shkurtimi i shkollave profesionale nga rreth 400 ne 1990 ku pjesa dermuese 75 perqind ishin te profilit bujqesor, ne 44 ne 1994. Pervec kesaj u realizua per arsimin profesional, ndarja ne dy nivele specializimi profesional, ku ne kurse tre vjecare synohet pergatitja e punetoreve te kualifikuar per tregun e punes dhe kurse 5 vjecare ku pergatiten specialiste ne nivel teknikesh.

Ngritja e sistemit te formimit profesional per te rritur me ane te 7 qendrave te permendura me siper synonte pregatitjen e fuqise punetore per nje treg te lire pune duke dhene dije dhe mjeshteri ne perputhje me vecorite e reja social ekonomike. Konkretisht keto qendra funksionojne ne qytetet Tirane (2 qendra: QFP 1 dhe QFP 4); Durres; Shkoder; Vlore; Korce; Elbasan. Dy qendrat qe funksionojne ne Tirane kane bere perpjekje te zgjerone gamen e kurseve te ofruara. Ne 5 qytetet e tjera ku jane ngritur keto qendra sic mund te vihet re ne tabelat bashkangjitur ne aneks numri i specialiteteve te ofruara eshte mjaft i kufizuar ne drejtim te gjuhës se huaj dhe kompiuterit. (Shtesa 2, Tabela 23). Kapaciteti trainues ne qendrat e trainimit publike te varura nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale eshte rreth 6,000 persona ne vit me kurset qe zgjasin nga 2 muaj deri ne 9 muaj. (Shtesa 2, Tabela 23, 23.1 dhe 23.2)

Megjithë perpjekjet qe vihen re, sidomos ne Tirane ku jane perqendruar edhe kapacitetet me te medha trainuese private, akoma le per te desheruar pershtatja dhe dhenia e kurseve qe i pergjigjen kerkesave te tregut te punes. Gama e kurseve te ofruara eshte akoma e ngushte. Ketu dominojne kurset e organizuara ne gjuhe te huaj kryesisht anglisht si dhe kompiuter e parukeri te cilat zene afersisht 70 perqind te te gjithë kurseve te ofruara (Shtesa 2, Tabela 24 dhe 24.1) Per sektorin privat te dhenat mungojne por mendohet qe ne te gjithë vendin numri i te trainuarve nuk i kalon 15000 vete. Per sherbime cilesore ne mund te permenden qendrat Don Bosko (Tirane), Murialdo (Fier) (Shtesa 2, Tabela 24.2). Ne shkollat profesionale studiojne gjithsej 15,000 nxenes dhe cdo vit mbarojne studimet rreth 3,000 studente. Ne keto shkolla zhvillohen 35 kurse ne dege te ndryshme te profesioneve. Me kryesoret jane elektrikist, mekanik, montues pajisjesh ventiluese dhe hidraulike, tapiceri, finance, elektronike, hoteleri, konfeksione, bujqesi, etj. (Shtesa 2, Tabela 25)

PROBLEME

Qendrat profesionale kane gjithashtu nje pavaresi te pjesshme ekonomike dhe u lejohet qe te vendosin tarifa per sherbimet qe ofrojne dhe t'i perdorin ato ne masen 90 perqind nga te cilat afersisht 50 perqind shkojne per investime.

Pregatitja e kursanteve ne keto qendra behet ne kushtet e mungeses se sistemit te standardeve te aftesive. Programet pregatiten nga vete instruktoret ne baze te eksperiences se tyre. Per fat te keq jo gjithmone keto jane ne perputhje me njohurite me te fundit profesionale dhe mund te mos i pergjigjen plotesisht kerkesave te tregut te punes. Si rezultat bie kesisoj edhe vlera e certifikates se leshuar nga keto qendra.

Problem është edhe mungesa e një sistemi për trainimin e trainereve dhe në asnjërin prej 7 qendrave publike të trainimit nuk egziston shërbimi këshillimor për kursantët se si të zgjedhin kurset që bëjnë për ta dhe rreth shanseve të tyre për punësim.

Po thuajse të gjitha qendrat publike por edhe ato jo publike vuajnë gjithashtu nga mungesa e lidhjeve me bizneset private që mund të ishte një burim i mirë të ardhurash dhe njëkohësisht një klient që do të rriste kërkesat për të ofruar kurse sa më afër kushteve të punës në veprimtaritë ku operojnë

Megjithatë për shkak të admirueshmërisë, sistemi i AFP në Shqipëri nuk është në nivelin e kërkuar për përgatitjen e një fuqie punëtore aktive dhe në gjendje t'i përgjigjet kërkesave të reja të ekonomisë së tregut. Arsyeja kryesore është prapambetja e trashëguar nga e kaluara dhe mungesa e fondeve të mjaftueshme për ta sjelle atë në nivelin e kërkuar kur dihet që AFP është mjaft i kushtueshëm. Konkretisht në sistemin e Arsimit Profesional janë kryer mjaft investime kryesisht nga donatorë të huaj që kanë synuar ngritjen e nivelit të përvetësimit të aftësive por kerkohen akoma shumë punë dhe investime për të arritur një nivel të kënaqshëm.

D. INFORMACION PLOTESUES

1. QEVERISJA LOKALE

Gjendja aktuale e pushtetit lokal është produkt i dinamikës së faktoreve politike, ekonomike, sociale dhe historiko-tradicionale gjatë tranzicionit. Pamvaresisht ndikimeve në aspektin pozitiv apo negativ, të gjithë sëbashku kanë luajtur dhe po luajnë rol në procesin e decentralizimit të fuqisë në pushtetin lokal dhe rritjen e aftësive veteqeverisëse të tyre. Në vitin 1992 reforma institucionale krijoi për të parën herë pushtete e pavarura lokale duke shënuar në të njëjtën mënyrë edhe një arritje të rëndësishme. Disa nga funksionet dhe shërbimet iu kaluan direkt pushtetit lokal, i cili është aktualisht politikisht autonom por i dobët nga pikpamja administrative dhe fiskale.

Që nga viti 1998, janë ndërmarrë hapa konkrete për thellimin e decentralizimit të pushtetit lokal nëpërmjet hedhjes së bazave të decentralizimit në 1998 me kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në 1999 me nënshkrimin e Kartës Europiane të Autonomisë Lokale dhe në vitin 2000 me ligjin mbi Organizimin dhe Fuqizimin e Qeverisjes Vendore. Sipas këtij ligji, njësitë administrative janë Komuna, Bashkia dhe Qarku. Sipas këtij ligji 310 komunat dhe 64 bashkitë përbejnë edhe nivelin e baze të qeverisjes vendore ndërsa qarku i cili përfshin disa komuna dhe bashki përben nivelin e dytë të qeverisjes vendore.

Në vitin 1999, hartohet edhe strategjia e decentralizimit. Brenda vitit 2001, kjo strategji synon të përmirësojë sistemin e taksave lokale dhe të rrisë autonominë fiskale, të zhvillojë paketën ligjore mbi pronat publike me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e pronës publike të pushtetit lokal si edhe ndërtimin e kuadrit ligjor dhe institucional të pushtetit lokal dhe të financave publike. Në të ardhmen tendencat decentralizuese do të shtrihen në drejtim të decentralizimit të pushtetit qendror dhe delegimit gradual të kompetencave, atij lokal, në çështjet e arsimit, shëndetësisë apo punësimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve të mesimperme në përputhje me nevojat e komunitetit. Decentralizimi përfshin jo vetëm ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar por edhe aftësimin e pushtetit lokal në financimin dhe administrimin e këtyre shërbimeve.

2. PROJEKTET

Egzistojne nje numer I konsiderueshem projektesh per shendetsine te cilat konsistojne kryesisht ne rehabilitimin e QSH e spitaleve por edhe ne trajnimin e stafit mjeksor. Nje pjese e tyre kane perfunduar ndersa nje pjese vazhdojne deri ne vitin 2004 . Rezulton se disa nga donatoret me te shpeshte ne kete fushe jane ECHO, UNICEF, AEDP, OFDA, si dhe Qeveria Italiane e ajo Franceze, ndersa organizatat qe aplikojne ne terren keto projekte jane IMC, AMI, MERLIN, CESVI, COOPI etj. Rethet qe kane perfituar me shume nga keto projekte ne shume parash jane Elbasani, Gramshi, Tirana, Peshkopia etj., por ne kete liste nuk perfshihen aspak rrethe si Malsi e Madhe, Tropoje, Hasi, Puka, Mirdita, Mati, (siç shihet nje pjese e madhe e Shiperise verilindore) por edhe rrethe si Korça, Kuçova, Pogradeci, e Librazhdi te cilat kane gjithashtu shume nevojë per projekte te tilla po te merret parasysh gjendja e amortizuar e sherbimit shendetsor paresor e spitalor. Ketu duhet shtuar se edhe ne ato rreth ku ka pasur projekte perseri shfaqen probleme te cilat natyrisht kerkojne kohe per tu mbyllur apo permirsuar. (Shtesa 2 , Tabela 19)

Nga viti 1992-1998, ne sferen e mbrojtjes shoqerore Banka Boterore, nderhyri me projektin e «Zhvillimit te Rrjetit te Mbrojtjes Shoqerore ne Shqiperi» me vlere 10 milion USD. Ky projekt ka realizuar zhvillimin institucional te Ministrise se Punes dhe te 4 agjensive ekzekutive te saj, ndertimin e bazes ligjore te gjithë sistemit te mbrojtjes shoqerore, zhvillimin e burimeve njerezore te nenpunesve te rrjetit te sherbimeve shoqerore ne nivel qendror dhe lokal nepermjet trainimeve aftashkurtera dhe afatamesme, ka mbeshtetur nxitjen e biznesit te vogel dhe punesimit nepermjet krijimit te Fondit per Punesim dhe Vetepunesim, si edhe ka mbeshtetur kompletimin me paisje zyresh dhe sistem kompjuterik ne te gjithë sistemin e Ministrise se Punes ne nivel qendror dhe lokal. Rrethet me te mbeshtetura nga ky projekt kane qene kryesisht qytetet e Tiranës, Shkodres, Elbasanit, Vlores, Fierit, Korces. Ne 2000, B. Boterore ka rifilluar zbatimin e projekti te dyte e me nje vlere totale 14 million dollare. Ky projekt synon zhvillimin dhe shperndarjen e sherbimeve sociale deri ne nivel bashkie dhe komune, nepermjet zhvillimit te nje kuadri politik dhe institucional te afte per sherbime sociale komunitare, zhvillimin e kapaciteteve qendrore dhe lokale ne ofrimin e sherbimeve sociale, promovimin e formave te reja dhe cilesore ne fushen e sherbimeve sociale si edhe rritjen e perfshirjes se qeverise lokale dhe OJQ-ve ne mbeshtetjen e grupeve te rrezikuara ne Shqiperi.

3. MEDIA

Mediat pesuan nje ndryshim rrenjesor pas vitit 1990. Ndersa me pare nuk egzistonin mediat private por vetem ato te kontrolluara teresisht nga shteti dhe teper te ideologjizuara kemi nje bum te mediave elektronike e te shkruara pas vitit 1991. Aktualisht ne Shqiperi egzistojne aktualisht 54 radio private dhe 62 TV private³¹ shumica e te cilave jane lokale dhe disa nacionale. (Shtesa 2, Tabela 26) Persa i perket medias se shkruar egzistojne shifra me te peraferta, sepse krahas krijimit te nje numri te madh gazetash e revistash pas 1991, disa prej tyre falimentuan kurse disa te tjera vazhdojne te lindin edhe sot.

Roli i medias se pavarur eshte tashme nje realitet i prekshem per publikun e gjere duke i ofruar atij jo vetem informacion por edhe nje shumllojshmeri pikpamjesh e idesh te shoqerise aktuale. Legjislacioni ne fushen e medias i eshte nenshtuar nje zhvillimi ne te cilin nje rol te rendesishem kane luajtur Shoqatat e Gazetareve, Qendra e Medias se fondacionit SOOROS, Instituti i Medias, etj. Persa i perket legjislacionit ai ka nisur ne 1993 me mbrojtjen e lirise se shtypit dhe te drejten e shtypit per te informuar, ne vitin 1997 me ligjin per radiot e TV

³¹ Studim I bere nga Instituti I Medias, 2000

private, ne 1998 me krijimin e Keshillit Kombetar i Radiove dhe Televizioneve si organ per licensimit te mediave te ndyshme dhe me mbrojtjen e te miturve nga media.

Media e Shkruar. Egzistojne te pakten 68 gazeta e revista ne Shqiperi. Prej ketyre 32 numerohen neper rrethe. Sipas llojit te popullsise qe i drejtohen renditen: te huaja 1, te minoritetit 5, te femijeve 7, fetare 3 dhe pjesa tjeter per te gjithë llojet e publikut. Gazeta partiake jane te majta 3, te qendres 5, te djathta 5. Pronesia e organeve te shtypit te huaja 2, shoqata 5, Parti 13, te tjerat jane private. Numri i korrespondenteve ne rrethe sidomos per gazetaret me shtrirje nacionale ka ardhur duke u rritur dhe disa prej tyre me tirazh me te madh mbulojne 100 perqind te territorit te Shqiperise me korrespondente. Kjo ka sjelle qe popullsia lokale t'i bleje keto gazeta edhe per lajmet lokale qe ofrojne e jo vetem per ato kombetare e nderkombetare. Pjesa me e madhe e gazetave shitet nepermjet pikat e shitjes, nderkohe qe numri i te abonuarve te rregullt eshte i vogel. Kjo nuk do te thote se shtypi nuk konsumohet por, preferohet te blihet çdo dite. Nje nga problemet e konstatuara ne rrethe ishte besueshmeria ndaj informacionit te tyre. Kjo besueshmeri eshte me e i larte per gazetare te huaj³². (Shtesa 2 , Tabela 27)

Televizionet Private. Nga 64 TV private qe egzistojne ne Shqiperi, vetem 20 gjenden me qender ne Tirane ndersa te tjerat neper rrethe. Rrethe si Kurbini, Librazhdi, Bulqiza apo Kukesi kane TV private lokale. Por jo gjithmone kjo shtrirje e ketij rrjeti perkon me cilesine e programeve. PEr shkak te kohes se shkurter te funksionimit te kesaj medie dhe mungeses se zbatimit te statusit te ri ligjor, ne rrethe jashte Tiranes, sundon pirateria elektronike. Numri total i punonjesve ne Televizionet private ne vitin 1998 ishte 301,³³ prej te cileve 32 jane te diplomuar per gazetari 27 te specializuar ne kurse dhe 242 bashkepunetore te jashtem. Nje pjese e ketyre gazetareve kane fakultete te shkencave shoqerore apo ekonomike ose jane studente te Deges Gazetari ne UT. Fenomeni i punesimit te studenteve shfaqet edhe ne drejtimet e tjera te medias dhe nje nga shkaqet eshte se ato mund te punesohen pa kontrata te rregullta e mund te paguhen me pak.

Radiot Private. Nga 54 stacione radioshoqerore ne shkalle vendi, 28 jane ne Tirane ndersa pjesa tjeter eshte e shperndare neper rrethe dhe jane kryesisht lokale. (Shtesa 2 , Tabela 26) Numri i te punesuarve ne radiot private eshte 185, nga te cilet numri gazetarve eshte 63, ndersa personeli tjeter 122. Numri i bashkepunetoreve te jashtem arrin ne 116.

Persa i perket menyrave te tjera te informacionit, perdorimi I internetit po rritet shume shpejt ne rrethet e medha dhe eshte kryesisht I mbeshtetur nga privatet per qellime biznesi apo institucionet shteterore. Shifra te sakta mbi numrin e perdoruesve te tij ende nuk ka.

³² Studimi I bere nga Qendra e Medias e Fondacionit SOROS, ne 1998, ne qytete Vlore, Tirane dhe Shkoder.

³³ Qendra e Medias e Fondacionit SOROS


KAPITULLI I TRETE: VLERESIMI I SITUATES

A. VARFERIA

Treguesit e varferise ekonomike dhe shkalla e varferise: Varferia ne Shqiperi ka karakter shumedimensional Ajo nuk identifikohet vetem me te papunet apo me familjet qe jetojne ne varferi ekonomike, por perfaqsohet gjithashtu me kategori te cilat jane te perjashtuara nga te drejta themelore per te patur nje banese, ushqim te mjaftueshem, ngrohje dhe veshje ne dimer, pune ne perputhje me aftesite fizike dhe nivelin aresimor, shkolle afer shtepise dhe mundesi per ta ndjekur ate, akses ne sherbim shendetesor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, te drejte dhe ze per te kerkuar te drejtat. Megjithese se varferia eshte identifikuar si nje pabarazi ne shperndarjen e te mirave materiale midis shtresave te ndryshme te popullsise, « te ardhurat » eshte aktualisht, indikator me i rendesishem dhe me perfaqsesi i pabarazise dhe varferise.

Bazuar ne kete tregues si edhe ne politiken aktuale per mbrojtjen ndaj varferise nepermjet skemes se Ndhimes Ekonomike, mund te themi se ne Shqiperi jetojne nen nivelin zyrtar te varferise rreth 149,000 familje.³⁴ Keto familje te cilat ndodhen aktualisht ne skemen e ndihmes ekonomike rezultojne te jene pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme. Ky numer familjesh i kthyer ne individe tregon se ne daren e varferise ekonomike, ndodhen 24 perqind e popullsise totale te Shqiperise.

Popullsia sipas prefekturave krahasuar me popullsine ne skemen e ndihmes ekonomike.



Vecorite e varferise ekonomike ne Shqiperi

Te gjitha treguesit flasin per nje permase rajonale te varferise, e cila ne nje fare menyre pershkron dallimin veri - jug, fshat-qytet, zone malore e zone bregdetare. i ndare ne 4 grupe te medha kontigjent i familjeve te varfera sipas zonave do te ishte ne kete menyre:

³⁴ INSTAT- Shqiperia ne shifra/Shtator 2000

Grupi i pare : 0-10 perqind e popullsisë perfishire ne skemen e ndihmes ekonomike
Grupi i dyte : 10-20 perqind e popullsisë perfishire ne skemen e ndihmes ekonomike
Grupi i trete : 20-40 perqind e popullsisë perfishire ne skemen e ndihmes ekonomike
Grupi i katert : mbi 40 perqind te popullsisë ne skemen e ndihmes ekonomike dhe perfaqson zonat me varferi ekstreme.

Niveli i varferise ekonomike eshte me i larte ne zonen veriore dhe verilindore te Shqiperise. Kjo lidhet me mundesite e kufizuara per pune dhe te ardhurave te ulta, vecanerisht ne bujqesi. (shih papunesine). Sipas te dhenave mbi token bujqesore ne pronesi ne kete zone rreth 70 perqind e familjeve zoterojne me pak 1,000m² toke bujqesore per fryme³⁵ dhe te nje cilesie te ulet. Mundesia e kufizuar per te perdorur sherbime publike te kondicionuara nga infrastruktura e varfer eshte nje faktor tjetër qe ndikon ne rritjen e varferise ne zonen veriore dhe verilindore te Shqiperise.


Tabela 28 Treguesit e varferise sipas qarqeve

Qarku	Zona Gjeografike	Popullsia qe merr ndihme ekonomike	Ne perqindje
Kukes	Veri	63,036	45
Diber	Veri-Lindje	86,027	45
Shkoder	Veri	115,245	34
Lezhe	Veri	47,268	24
Berat	Qender	57,847	23
Elbasan	Qender	90,437	21
Korce	Jug-Lindje	59,315	17
Tirane	Qender	74,093	11
Fier	Jug-Perendim	30,636	9
Gjirokaster	Jug	13,815	8
Vlore	Perendim	20,853	7
Durres	Perendim	18,648	6

Ne Qarqet Kukes dhe Diber mesatarisht mbi 45 perqind e popullsisë jeton nen nivelin e varferise, dhe perballon pjesen me te madhe te shpenzimeve te jeteses me te ardhurat nga ndihma ekonomike. Ne shtate shume pak me te mire jane qarqet Lezhe dhe Shkoder te cilat kane ne skemen e ndihmes ekonomike mesatarisht 20-34 perqind te popullsisë. Analiza brenda qarqs tregon se ne varesi te disa faktoreve (largetsia me qendren, lartesia mbi nivelin e detit, sasia e tokes bujqesore per fryme), nivei i varferise ndryshon deri ne ekstremitet. 16 Komuna ne qarkn e Shkodres, 14 Komuna ne qarkn e Kukesit, 14 Komuna ne qarkn Diber, 8 Komuna ne qarkn Korce dhe 8 Komuna ne qarkn Elbasan, kane ne skemen e ndihmes ekonomike nga 45 perqind-90 perqind te popullsisë qe jeton ne territorin e tyre. Ne Shkoder, ne Komunën Pult, Shale, Shosh, Postribë, Mnel Vig popullsia qe perfiton ndihme ekonomike varion nga 80-93 perqind. Ne qarkn Diber, komunat Slllove, Xiber dhe Kala e Dodes dhe ne qarkn Kukes, komunat Bushtrice, Surroj, Gryke e Cajes, Topoje e Fierze, kane mbi 60 perqind e popullsisë ne ndihme ekonomike.

³⁵ INSTAT- Rregjistrimii Pergjitheshem I Njesive Ekonomike Bujqesore, Qershor 1998.

VARFERIA EKONOMIKE SIPAS KOMUNAVE DHE BASHKIVE



Vecorite e varferise ekonomike sipas ndarjes ne zone urbane dhe rurale

Egzistojne dallime ne nivelin e varferise ekonomike sipas ndarjes zone rurale dhe urbane. Mbeshtetur ne studimin mbi « Matjen e standarteve te jeteses » realizuar nga INSTATI ne 1996, 90 perqind e te familjeve qe i perkasin decilit me te varfer, jetojne ne zonat rurale dhe 60 perqind e kryefamiljareve te ketyre familjeve jane te vetpunesuar ne bujqesi³⁶. Ne zonat rurale, elementet percaktues te varferise, jane siperfaqja e vogel e tokes ne zoterim, numri teper i kufizuar i gjese se gjalle si edhe te ardhurat e pakta nga aktivitete ekonomike jashte fermes qe mund te sigurohen nga punesimi kundrejt nje page apo nga dergesat ne para te emigranteve.

Tabela 29 Ndarja e familjeve ne skemen e ndihmes ekonomike sipas zonave rurale dhe urbane

<i>Zona</i>	<i>Numri i familjeve ne skemen e ndihmes ekonomike</i>	<i>perqind e familjeve ne skemen e ndihmes ekonomike</i>
Zona Urbane	66,196	44 perqind
Zona rurale	83,446	66 perqind
Gjithsej	149,642	100 perqind

E njejta gje konfirmohet edhe nga te dhenat statistikore te ndihmes ekonomike. Po te analizojme grupin e katert, qe klasifikohet si grupi i komuniteteve me te varfera, 93 perqind e popullsisë qe perfiton ndihme ekonomike jeton ne fshat dhe identifikohet me 66 komuna³⁷, ndersa 7 perqind jeton ne qytet me 2 bashki. Zona e thella malore karakterizohen nga nje varferi ekonomik me e thelle se ajo zonave qe ndodhen rreth qyteteve. Infrastruktura dhe afersia me tregun ka ndikim ne nivelin e varferise ekonomike. Nje shkaktar tjetër i varferise ekonomike eshte edhe degradimi i burimeve egzistuese natyrore si uji, pyjet, kullotat dhe peshku dhe ulja e vazhdueshme e te ardhurave nga cfrYTEZIMI i tyre. Zonat perreth liqenit te Prespes dhe Ohrit po sigurojne te ardhura gjithje e me te pakta nga peshkimi ndersa banoret perreth pyjeve te Pukes, Mirdites, Malesise se Tiranës (Bize) po vuajne nga i njejti problem ekonomik³⁸. 46 perqind e familjeve te varfera jetojne ne qytete. Shkaktari kryesor i varferise ekonomike ne qytete eshte papunesia dhe ne menyre te vecante ajo afatgjate. (Shih papunesine)

Vecorite e varferise ekonomike per familjet migruese.

Varferia ekonomike eshte gjithashtu e pranishme dhe kercenuese edhe ne vendbanimet e reja te krijuara nga migracioni i brendshem. Migracioni drejt zonave me potencial te larte ekonomik e ne menyre te vecante drejt Tiranës dhe Durrësit, ka bere qe te krijohen vendbanime te medha te paligjeruara, nga familje qe jetojne ne varferi te plote jo vetem ekonomike por edhe ne aspektin social. Tirana dhe zona suburbane (periferike) e saj, Kamza dhe Paskuqani, jane shembujt me tipik te ketij fenomeni i cili nuk ka mundesi te frenohet. Popullsia ne rajonin e Tiranës eshte rritur me ritme mararmendese (rreth 37 perqind ne gjashte vjet), nderkohe qe Kameza e ka rritur popullsinë e vet me 393 perqind ose 4 here, dhe

³⁶ INSTAT, Treguesit Sociale, 1997

³⁷ ne Shqiperi ka 374 njese administrative nga te cilat, 310 jane komuna dhe 64 jane bashki.

³⁸ Strategy to decrease the level of illegal logging. FAO, May 2000.

Paskuqani 365 perqind ose 3,6 here. Familjet e migruara ne Kamez e Paskuqan perfaqsojne perkatesisht 55 perqind dhe 30 perqind te numrit te familjeve te migruara ne Rrethin e Tiranes.² Pjesa me e madhe e ketyre familjeve nuk kane pronesi mbi token ku kane ngritur shtepite dhe kane fare pak ose aspak infrastrukture. Shoqerues te ketij fenomeni jane shfaqur edhe probleme te tjera te lidhura ngushte me varferine e ketyre familjeve. Se pari, duke qene se keto familje kane braktisur vendbnimet e vjetra e si rrjedhoje edhe pronat nuk kane te drejte te perfitojne nga skema e ndihmes ekonomike, pra rezultojne pa asnje te ardhur. Se dyti, ndertimi spontan i banesave ka cuar ne degradimin e gjendjes se ambjentit urban, shkaktuar nga hedhja e mbeturinave dhe derdhjes se ujrave te zeza. Se tret,i familjet duke mos qene te rregjistruara ne gjendjen civile te njesise administrative jane te izoluara dhe nuk kane akses tek shkolla, ambulanca, sherbimet sociale, etj.

Ndikimi i perberjes se familjes dhe i struktures se saj ne varferine ekonomike

Vecorite demografike lidhen ngushte me varferine, vecanerisht madhesia e familjes e sidomos numri i madh i femijve ka nje korrelacion te forte me te. Familjet me mbi 3 femije jane familje te cilat kane probabilitet me te madh per te qene te varfera. Rreth 68 perqind e familjeve kane ne strukture me 2 breza (prinder- femije) dhe 24 perqind e atyre qe kane 3 ose me shume femije, kategorizoheshin te varfera. Ne rastet e familjeve me nje prind, kur mbajtesi i saj eshte femer, probabiliteti per te qene i varfer eshte me i madh se ne rastin kur mbajtesi i familjes eshte mashkull. Sipas te dhenave, ne rastin e pare 36 perqind e familjeve jetojne ne varferi, kundrejt 0,9 perqind te rastit te dyte³⁹

Tabela 30 Shperndarja e familjeve qe marrin ndihme ekonomike sipas vendbanimit dhe numrit te anetareve

Zonat	Familje me 1 anetare	Familje me 2 anetare	Familje me 3 anetare	Familje me 4 anetare	Familje me 5 anetare	Familje me 6 anetare	Familje mbi 6 anetare
Zona Urbane	5,433	6,752	12,332	23,812	11,422	4,014	2,431
Zona Rurale	4,122	8,128	13,210	19,567	15,880	10,529	12,010
Gjithsej	9,555	14,880	25,542	43,379	27,302	14,543	14,441

Tabela 31 Karakteristika te familjeve me te ardhura per njesi konsumi nen 40 dhe 50 perqind te medianes

(Mediana e te ardhurave mujore per fryme= 6079leke)

Tipi i familjes	40 perqind e medianes	50 perqind e medianes

³⁹ INSTAT / Te dhena te nivelit te jetese, Tetor 1998

Person i vetem	13	18
Cift pa femije	6	10
Cift me nje femije	9	12
Cift me dy femije	12	17
Cift me tre+ femije	20	28
Familje e zgjeruar	12	18
Familje monoparentale	15	20
Familje te tjera	13	19

Kryefamiljaret pensioniste, nuk jane te varfer por, kur ata mbajne anetare te tjere te familjes ka te ngjare te jene te tille. Ky tregues i krahasuar me vende te tjera te Europes Lindore dhe te Ballkanit tregon se ky grup individesh ka shkallen me te ulet te varferise. Kjo tregon se pensioni perben nje dergese te rendesishme shoqerore qe shmang ose kufizon varferine.

Gjendja ekonomike e familjes ndikon ne paaftesine e anetareve te saj. Rreth 5451 familje te varfera (marrin ndihme ekonomike) kane nje ose dy anetare te paafte ose 22 perqind e te paaftëve I perkasin familjeve te varfera. Renditja e zonave me paaftesi te theksuar ndjek pothuajse te njejten renditje me zonat ku varferia eshte me prezente.

B. KATEGORITE SOCIALE NE RREZIK

Shkaqet e statusit « te rrezikuara »

Shkaqet e te qenit te rrezikuar i gjejme ne pabarazine sociale, kulturore, ekonomike, shendetesore dhe aresimore, brenda shoqerise shqiptare si edhe ne dobesine e institucioneve sociale (familjes, ekonomise, shtetit, aresimit dhe fese) per te plotesuar nevojat sociale baze. Kjo pabarazi ka egzistuar edhe me pare, por transicioni po e ben me evident dhe e thellon. Pergjithesisht grupet ne risk vijne nga shtresa shoqerore me nje nivel te ulet ekonomik, me nivel te ulet aresimor, me nivel te larte te papunesise. Individe te grupeve ne risk kane nevoja te cilat jane te mbuluara dobet ose te zbuluara nga sherbimet e institucioneve sociale te mesiperme, per kete aresye pabarazia e mesiperme thellohet dhe zgjerohet. Familje te varfera qe nuk mbeshteten ekonomikisht, nuk plotesojne as konditat baze jetesore dhe sociale. Te paafte qe nuk integrohen do te mbeten totalisht te varur ndaj familjes duke e rrenuar ekonomikisht dhe moralisht. Te rinj te papune i drejtohen pa rruge dalje droges, kriminalitetit apo prostitucionit, femije te varfer abandonojne shkollen dhe i drejtohen rruges per te lypur ose punuar, gra te dhunuara, te cfrytezuara e deri te kercenuara, nenshtrohen pa patur mundesi per rruge daljeje.

RREZIKU I PERJASHTIMIT SOCIAL NE GRUPIN E FAMILJEVE RE VARFERA

Nje studim i vitit 1999, tregon se struktura e familjeve ne ndihme ekonomike tregon se 75 perqind e tyre ose rreth 100,000 familje⁴⁰, pervec problemeve ekonomike (mungeses se te ardhurave) perjeton edhe probleme sociale si divorcin, vdekjen e njerit prej kryefamiljareve, paaftesine, problemet e shendetit apo papunesine. Pamvaresisht se famijlet me mbi 4 anetare jane edhe me te mbeshteturat financiarisht, 70 perqind e tyre treguan se ndihma ekonomike ishte teper larg plotesimit te nevojave te domosdoshme jetesore. Ky fakt rikonfirmohet gjithashtu edhe per familjet ne ndihme ekonomike te pjeseshme ku 54 perqind e tyre, treguan se ndihma ekonomike vetem u permireson nevojat ekonomike por jo ato sociale. Ne realitet kjo tregon se nuk ka ende nje lidhje midis perberjes sociale te familjes, nevojave sociale te saj dhe ndihmes ekonomike. Shkalla e perjashtimit ekonomik dhe social eshte me e larte tek familjet me nje prind, familjet me femije te pafte dhe familjet me te moshura ose me te semure⁴¹.

Tabela 32 Klasifikimi i familjeve qe marrin ndihme ekonomike sipas indeksit te perjashtimit social.

Lloji i familjeve qe marrin Ndhme ekonomike	Piket
Familje me nje prind	49
Familje me nje prind dhe femije nen 16 vjec	40
Familje me nje prind dhe femije te semure	36
Familje me dy te moshuar ose te semure	32
Familje me nje prind me femije te pafte	27
Familje te medha	27
Familje me te moshuar dhe femije	20
Familje me persona te moshuar ose te semure	20
Familje te tjera	20
Femije pa prinder	10

⁴⁰ Arlinda Ymeraj, Roli I mbrojtjes sociale tek zhvillimi I kapitalit social dhe reduktimi I perjashtimit social”, 1999

⁴¹ Arlinda Ymeraj, Roli I mbrojtjes sociale tek zhvillimi I kapitalit social dhe reduktimi I perjashtimit social”, 1999

Grupet kryesore te rrezikuara

Faktet e mesiperme tregojne se ndihma ekonomike per shkak te pagesave teper te ulta, nuk i ndihmon familjet per te dale nga varferia ekonomike. Kjo varferi e kombinuar me injorancen, problemet ne sistemin aresimor, ate shendetesor, strehimim si edhe ne pergjithesi ne indiferencen e shoqerise, ndikon direkt ne agravimin e margjinalitetit te individeve te familjeve te varfera. Nderkohe qe varferia ekonomike eshte e mateshme dhe e identifikuar territorialisht, te dhenat zyrtare ne nivel komunitar, varferia ne kuptimin si perjashtim social nga te drejtat themelore te njeriut, eshte ende e panjohur.

Te dhena te APNSHS si edhe nga Studimi mbi « Vleresimin Sasior dhe Cilesor te Vulnerabilitetit ne Shqiperi »⁴² kane identifikuar 5 grupe te rrezikuara te cilat perbehen, gjithashtu nga nen kategori:

Femije ne risk : (femije qe lypin, femije qe punojne, femije qe abandonojne shkollen, femije ne jetimoret publike, femijet e ngjuar per shkak te gjakmarrjes)

Gra dhe vajza ne risk (gra te dhunuara, gra te divorcuara, gra kryefamiljare, gra te trafikuar dhe priosituta)

Te rinj ne risk (te droguar, te papune, te perfshire ne aktivitete kriminale ose ne krime)

Te moshuar te vetmuar/abandonuar

Te paafte fizike dhe mendore (nga lindja, femijeria ose invalide)

Vezhgimi dhe intervistat me nje pjese te nenpunesve te APNSSh-se dhe te seksionit te ndihmes ekonomike ne disa komuna dhe bashki, nxorren si konkluzion se ende sot, nuk ka te dhena te plota mbi margjinalitetin, lidhur me permasen, dhe shperndarjen territoriale. Skema aktuale e mbrojtjes shoqerore, sistemi aresimor, ai shendetesor, gjygesor dhe policor jane te papregatitur dhe ineficente ne mbrojtjen apo integrimin e tyre ne jeten normale. Per te gjitha grupet e mesiperme, mund te thuhet se sherbimet sociale jane teper te limituara ne nivel nacional dhe pothuajse nuk egzistojne ne ne nivel komunitar (bashki dhe komune). Nderkohe qe mbeshtetja ekonomike, qe i behet te paafteve, te te moshuarve apo familjeve te varfera nepermjet pagesave te sigurimeve shoqerore, pageses se paaftesise dhe ndihmes ekonomike, eshte e ulet por e shperndare mire gjeografikisht, sherbimet sociale ne natyre klasifikohen si inegzistente ose teper te limituara⁴³.

Ndermjet grupeve te rrezikuara dhe varferise ekonomike nuk ka nje ndarje te prere dhe shperndarja territoriale e njejte. Grupet ne risk dhe familjet ne varferi ekonomike jane kategori fleksible dhe me probleme te nderlidhura dhe pergjithesisht jane rezultate te ezistences se njeri-tjetrit. Prostitutat dhe grate e trafikuar jane te papuna dhe jetojne brenda familjeve te varfera. Ato njekohesisht, gra te dhunuara, perdoruese te droges dhe ndoshta edhe nena te femijeve te ardhshem te abandonuar. Femijet ne familjet me nje prind, jane femije qe jetojne ne varferi ekonomike, dhe me shume te predispozuar per te abandonuar shkollen apo per te punuar. Te rinj te papune apo te rinj qe nuk kane aresimin fillor jane ne rrezik per te qene shoqerisht te perjashtuar dhe per tu perfshire ne rrugen e krimnalitetit. Femijet me aftesi te kufizuar jane te perjashtuar nga aresimimi, sherbimet rehabilituese, ndersa te rinjte dhe adultet ndaj trainimit profesional dhe punesimit ne perputhje me llojin she shkallen e paaftesise.

Margjinaliteti eshte me thelle zonat rurale. Kjo pjese e popullsise eshte totalisht e perjashtuar nga e drejta e perfitimit te sherbimeve sherbimeve sociale dhe e sherbimeve te punesimit pasi sistemi aktual i sherbimeve te mesiperme, eshte i pranishem vetem ne qytete.

⁴² World Bank, Quantitative and Qualitative vulnerability needs assessment. August 2000.

⁴³ World Bank, Quantitative and Qualitative vulnerability needs assessment. August 2000

Perjashtimi Social dhe Treguesit e Integruar

Shqipëria po përjeton një situatë kritike sociale, e cila ka patur një ndikim të shumanshem në treguesit e saj sociale. Në fazën aktuale të tranzicionit, probleme të reja sociale kanë lindur. Këto nuk janë të lidhura vetëm me varferinë ekonomike, megjithatë akoma varferia është një faktor thelbësor. “Varferia është uri. Varferia është pamundësi për t’u strehuar. Varferia është të jesh I semurë dhe të mos kesh mundësi të të vizitohesh tek një doktor. Varferia është pamundësi për të shkuar në shkollë, padituri, analfabetizem. Varferia është papunësi, frikë për të ardhmen, varferia është të jetosh nganjehere. Varferia është të humbasësh një fëmijë nga mungesa e higjenes dhe uji të pijshëm, ose nga keqshqyerja. Varferia është të jesh një ze i pafuqishëm, të mos kesh të drejtën e përfaqësimit dhe lirisë”.⁴⁴ Një mesazh i qartë rrjedh nga ky perkufizim i varferisë: varferia në vetvete do të thotë të jesh i përjashtuar në shoqëri. Si mund të matet përjashtimi social?

Autoret janë përpjekur të krijojnë një indeks të treguesve të ndryshëm me qëllim që të masin përjashtimin social, mbështetur në rezultatet e këtij studimi. Autoret ndertuan një sistem pikësh për të treguar rëndësinë dhe peshën specifike të secilit nga treguesit me të rëndësishëm sociale. Mbështetur në të dhënat e siguruar nga institucionet shtetërore, “Varferia ekonomike”, “Vdekshmëria foshnjore” dhe “Braktisja e shkolles” janë përzgjedhur si treguesit me përfaqësues për krijimin e indeksit të përjashtimit social.

Rezultati nga 1 (niveli me I lartë) tek 36 (niveli me I ulët i treguesit) japin vlerën e treguesve të zgjedhur për secilin nga 36 qarqet. Rezultantja e tyre (niveli me I lartë i mundshëm është 108) jep vlerën e treguesit të përjashtimit social. Analiza e vlerave që rezultojnë nga ky indeks tregojnë një lidhje të fortë ndërmjet rezultatit dhe situatës reale. (Shtesa 2, Tabela 33)


Një hartë kombëtare është përgatitur mbështetur në treguesit e integruar. Qarqet e Shqipërisë janë klasifikuar në 4 grupe, ku në grupin e parë bëjnë pjesë pikërisht ato që kanë treguesit e përjashtimit social më të lartë. Këto janë rrethet e zonës verilindore të Shqipërisë Dibrë, Bulqizë, Kukës. Kjo do të thotë që aty ku varferia është më e madhe edhe treguesit social të arsimit dhe shëndetësisë janë më të ulët.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë 19 rrethet midis të cilëve edhe Tirana dhe Shkodra. Sistemi i pikeve për çdo tregues të përdorur në këtë klasifikim na tregon se në disa raste ka edhe shmangje nga korrelacioni që ekziston midis gjendjes ekonomike dhe gjendjes sociale të rrethëve të caktuara. Kështu për shembull në Mirditë megjithatë ka varferi, fenomeni i braktisjes së shkolles nuk është i pranishëm. E kundërta e kësaj ndodh në rrethin e Shkodrës ku gjendja ekonomike nuk ka të njëjtin nivel me vdekshmërinë foshnjore dhe braktisjen e shkolles. Autoret shpjegojnë se fenomeni i vdekshmërisë foshnjore në rrethet si Shkodra nuk ka të bëjë me mungesën e të ardhurave por me fenomenin e migrimit dhe me faktin se familjet e migruar jetojnë në banesa të perkohshme, të papërshtatshme dhe ata nuk përfitojnë as ndihmë ekonomike. Po me migrimin lidhet edhe fenomeni i braktisjes së shkolles. Në shumë zona me popullsi të ardhur rishtaz fenomeni i braktisjes së shkolles është i pranishëm në masë të konsiderueshme. Në këtë raport është përmendur Kamza e Paskuqani.

Në grupin e tretë dhe të katërt ku bëjnë pjesë 14 rrethet, korrelacioni midis treguesve të përdorur është mjaft i fortë. Studimi i vëmendshëm tregon se në përgjithësi këto janë rrethet të patronitura nga fenomenet shpërthyes dramatike të tranzicionit, dhe për rrjedhojë në këto rrethet nuk janë prekur vlerat tradicionale. Gjithashtu në këto rrethet (Gjirokastra, Saranda,

⁴⁴ Raporti i Zhvillimit Botëror 2000/1- Duke luftuar varferinë

SITUATA SOCIALE DHE EKONOMIKE (sipas treguesve te integruar)



Delvina, Vlore e Fier) ka nje situatë me te mire ekonomike per shkak te nje niveli te larte punesimi ne emigracion jashte Shqiperise.

Ky raport duke synuar te jape nje pamje te pergjitheshme te situates social ekonomike ne vend ne nivel lokal, qartesisht percakton se:

1. Perjashtimi social eshte nje fenomen I cili mund dhe duhet te vleresohet nepermjet analizave te nje numri te ndryshem treguesish, te cilet tradicionalisht jane mohuar.
2. Ne Shqiperi, fenomeni I perjashtimit social tregon nje model gjeografik te qarte, me nivelet me te larta te perjashtimit ne zonen lindore dhe veriore, pergjate kufijve me Kosoven dhe Maqedonine, duke u permiruar ndjeshem pergjate levizjes ne jug dhe perendim, dhe
3. Ata qe pergatisin politika duhet te konsiderojne keta faktore kur pergatisin strategjite e luftes ndaj varferise, perjashtimit, diskriminimit dhe pabarazise.

REKOMANDIME

Analiza e situates social ekonomike evidentoi rrethe, komuna, bashki dhe kategori familjesh dhe individesh qe vuajne pasojat e papunesise, mungeses se sherbimeve sociale adequate, problemet e sistemit aresimor dhe sherbimit shendetesor. Reduktimi i varferise ekonomike dhe i perjashtimit social realizohet nepermjet hartimit te politikave afatmesme dhe afatgjata te cilat thellojne respektimin e te drejtave te njeriut, garantojne zhvillim ekonomik, kontrollojne emigracionin e brendshem si edhe rrisin eficencen e shpenzimeve dhe investimeve publike.

Nderhyrjet per zhvillimin ekonomik duhet te sigurojne:

- Permiresimin e treguesve makroekonomik qe ndikojne direkt ne mireqenien dhe reduktimin e varferise,
- Zhvillimin e politikave rajonale qe sigurojne zhvillimin ekonomik te zonave urbane dhe rurale, e ne menyre te vecante rajonet me potencial te larte ekonomik,
- Stimulimin e investimeve qe zhvillojne ekonomine bujqesore dhe sektorin privat,
- Zhvillimin e infrastruktures si faktor i rendesishen ne terheqjen e investitoreve te huaj dhe lehtesimin e sherbimeve publike qe lidhen me mbrojtjen shoqerore, aresimin dhe shendetesine.

Nderhyrjet per permiresimin e sherbimeve publike ne sistemin e mbrojtjes shoqerore, sistemin aresimor dhe shendetesor, perfshijne:

- Hartimin dhe implementimin e strategjive lokale per zbutjen e varferise dhe mbrojtjen e kategorive te margjinalizuara,
- Rritjen e investimeve publike ne sistemin mbrojtjes shoqerore, ate aresimor dhe shendetesor, si edhe perfshirjen e pushtetit lokal dhe komunitetit ne financimin dhe implementimin e tyre,
- Permiresimin e programit te ndihmes ekonomike drejt trajtimit te diferencuar te familjeve me nevoja ekonomike dhe sociale te ndryshme,
- Shtrirjen e sherbimeve aktive te punesimit dhe programet e formimit profesional edhe ne zonat rurale,
- Zhvillimin ne nivel bashke dhe komune te sherbimeve sociale per familje dhe individe ne nevoje
- Permiresimin e shperndarjes territoriale te rrjetit shkollor dhe te qendrave shendetesore paresore, kryesisht ne zonat rurale dhe zonat e mbipopulluara
- Permiresimin e gjendjes fizike te shkollave dhe qendrave shendetesore si edhe paisjen me mjete e domosdoshme per nje sherbim qe respekton te drejtat elementare njerezore
- Permiresimin ne shkolla te programeve mesimore, dhe te metodave te mesimdhencies,
- Prezantimin dhe zhvillimin brenda ambienteve te shkolles te sherbimeve te integruara per femije dhe te rinj si edhe te programeve speciale per femijet handikape apo femijet qe kane abandonuar shkollen, me qellim riintegrimin e tyre.
- Rritjen e cilesise se sherbimeve sociale, shendetesore dhe aresimore nepermjet perputhjes se nivelit te te punesuarve me kerkesat e vendit te punes, organizimit te vazhdueshem te kualifikimeve profesionale, respektimit te ligjit mbi sherbimin civil dhe vendosjes se nje sistemi te diferencuar pagash per sherbimet ne zonat e veshtira malore.

Nderhyrjet per thellimin e decentralizimit dhe fuqizimin e parimit te vetevendosjes lokale eshte faktor i rendesishem qe con ne permiresimin dhe zhvillimin e sherbimeve publike ne nivel bashkie dhe komune. Decentralizimi ne nivel local perfshin:

- Fuqizimin i autonomise financiare lokale,

- Permiresimin e legjislacionit mbi funksionimin e pushtetit lokal dhe delegimin e nje pjese te kopetencave vendimarrrese strukturave te pushteve lokale qe merren me mbrojtje shoqerore, aresim dhe shendetesi,
- Perfshirjen e autoriteteve locale ne procesin e hartimit dhe implementimit te politikave qe perfshijne zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sherbimeve publike,
- Zhvillimin e kapaciteteve lokale ne administrimin e sherbimeve publike, nepemjet ristrukturimit dhe tranimin profesional te administrates lokale.
- Perfshirja e organizmave jo qeveritare ne ofrimin e sherbimeve publike nepemjet permiresimit te legjislacionit dhe mardhenieve institucionale.

Problemet sociale dhe ekonomike te Shqiperise jane komplekse. Se pari, ato jane pazgjdhshmerisht te lidhura me dhe te varura nga trashegimia unike kulture dhe politike, dhe se dyti, te thelluara nga nje periudhe e gjate krizash te renda dhe zhvillimi tranzicional te brishte drejt nje shoqerie te re.

Si rezultat, keto probleme kerkojne vemendje te vecante te institucioneve qeveritare, komunitetit nderkombetar dhe shoqerise civile. Duke bashkepunuar me njeri tjetrin, ata duhet t'i trajtojne me qellim qe te terheqin vemendjen e opinionit publik ne njeren ane dhe te propozojne politika afatgjata, te qarta, te specifikuara dhe cilesore ne anen tjetere.

BIBLIOGRAFI

- INSTAT, « Tregu i punes » 1990-1999
- INSTAT, “Shqiperia ne Shifra”, 1997
- INSTAT, “Shqiperia ne Shifra”, 2000
- INSTAT, “Vjetari i treguesve Sociale”, 1999
- INSTAT, Disa tregues Social sipas qarqeve, 1998
- INSTAT, Sistemi i Mbrojtjes dhe i Sigurimeve Shoqerore ne Shqiperi, 1996
- INSTAT, Vjetari Statistikor I Aresimit, Dhjetor 1998
- UNICEF, “Studimi kombetar per mbulesen vaksinale”, 1999
- UNICEF, Te drejta e grave dhe femijeve ne Shqiperi, 1998
- UNFPA, “Programme review and strategy development”, 1997
- World Bank, “Institucional and capacity assessment of social services for vulnerable groups”, 2000
- World Bank, Albania, “Filling the Vulnerability Gap”, Mansura Rashid, Vajeera Dorabawila & Richard Adams, July 1999
- World Bank, Albania, “Household Welfare, the labour market and public programs in Albania”, World Bank, July 1999
- Arlinda Ymeraj, “The role of Social Protection to social exclusion and social capital” Robert MacNamara Fellowship Program, 1999
- CIGO, “Urgent rehabilitation of Schools and Prisons in Albania”, July 1998
- NACSS, Paper, “Social Assistance and Welfare in Albania”, May 1999
- Keshilli i Ministrave, Departamenti i Zhvillimit dhe i Kordinimit te Ndhimes se Huaj, “Programi i Investimeve publike” 1996-1998
- Brian Munday & George Lane, “The old and new. Changes in social care in Central and Eastearn Europe” EISS, 1998
- Observatori Kombetar Shqiptar “ Raporti kombetar i Observatorit Kombetar shqiptar” 1997
- Observatori Kombetar Shqiptar “ Raporti kombetar i Observatorit Kombetar shqiptar” 1999
- UNDP, Raporti I Zhvillimit Njerezor ne Shqiperi, 1998
- Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, Statistika, 1999
- Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, Statistika gjashtemujore, 2000
- Ministria e Shendetesise, “Vleresim i sherbimit shendetsor paresor” Raport i analizes statistikore i realizuar nga IMC ne bashkepunim me MSH, Tirane 1999.
- INSTAT- Buletin statistikor 3 mujor. Nr.4 Tirane 1999.
- Albanian Ministry of Health “Health Care Reform in Albania”, Background Document No.1 ‘Situation analysis’ Tirana 1996

Ministria e Shendetsise, Drejtoria e statistikes dhe e informacionit, Tirane 2000

Ministria e Shendetsise, Drejtoria e edukimit shendetsor, 'Udhezues mbi vaksinimin, Tirane 1999.

Ministria e Aresimit, Statistika 1999-2000,

SHTESA 1 : Definicione

Klasat e bashkuara; Konsistojne ne bashkimin e nxenesve te niveleve te ndryshme ne te njejtat ambiente dhe me te njejtet mesues.

Shkollat rajonale; Jane shkolla te bashkuara 8-vjecare e te mesme. Krijimi I ketyre shkollave eshte bere me qellim qe te ndihmoje rritjen e mundesive te femijve te zonave rurale per te ndjekur te gjitha nivelet e arsimit.

Udhezues diagnostik terapeutik, Botohen nga Drejtoria e Sherbimit Publik dhe permbajne udhezime per vaksinime ose trajtime te semundjeve te ndryshme.

Monitorimi I rritjes; Eshte I lidhur me konsultoret e femijve dhe si sherbim ndjek zhvillimin fizik e psikoemocional te femijve 0-6 vjec.

Sherbimi I shteses ushqimore; eshte I lidhur me problemin e kequshqyerjes ne kete raport, dhe nenkupton si praktikat e ushqyerjes se femijeve sipas parametrave shendetsore edhe shtesen e vitaminave te caktuara (A, D, jodit)

Familje e varfer, quhet familja pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme.

Te ardhurat e pamjaftueshme jane te gjitha te ardhurat mujore te familjes nen nivelin e varferise te caktuar administrativisht

Te paafte jane personat qe kane lindur te paafte ose jane bere te tille deri ne moshen 21 vjec ose deri ne 24 kur vazhdojne shkollen

Tregues te integruar; jane tregues sintetik te arsimit, shendetsise dhe varferise ekonomike

Papunesi afatgjate, quhet papunesia per me shume se 1 vit.

Nen-punesimi, perfaqson fenomenin e punesimit ne aktivite ekonomike, ne te cilat dita e punes zgjat me pak koha normale e punes (8 ore) ose dita e punes sjell te ardhura (ne natyre ose cash) me te vogla se se dita e punes me nje page minimale zyrtare. Njekoheshisht nen-punesimi nuk vjen per shkaqe te vullneteshme te individit dhe ky i fundit eshte i gatshem te kryeje nje pune tjeter.

Sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional; Sistemi i Arsimit dhe formimit apo trainimit qe synon te pajise njerezit me aftesi dhe njohuri punesuese (sipas kerkesave te tregut te punes).

Pregatitja profesionale fillestare ose baze; ka te beje me njohurite qe merren kryesisht ne sistemin arsimor por edhe me ane te kurseve te ndryshme dhe qe e lejojne individin te perftoje aftesi dhe njohuri per te hyre ne tregun e punes sipas aftesive qe ka fituar nga ky formim baze.

Formimi dhe Arsimi i vazhdueshem (i metejshem) profesional ose sistemi i trainimit per te rritur eshte sistemi trainues qe merret me zgjerimin dhe freskimin e njohurive dhe aftesive te perftuara ne arsimit baze dhe ofrohet per te rriturit qe kane marre nje formim baze qe i ka dhene atyre mundesi te hyjne ne tregun e punes ne perputhje me njohurite te perftuara.

(Sistemi) Standartet e Aftesive; sistemi i kategorizimit te nivelit te punonjesve sipas aftesive dhe njohurive profesionale.

SHTESA 2**Tabela 1 Ndryshimet ne popullsine e qarqeve, 1994-1996**

Qarku	Popullsia ne 1994	Popullsia ne 1996	Differenca	Ne %	Dendesia
Berat	222	218	-4	-2	121
Diber	215	218	3	1	84
Durres	221	248	27	12	324
Elbasan	383	362	-21	-5	113
Fier	297	390	93	31	207
Gjirokaster	137	143	6	4	50
Korce	342	297	-45	-13	81
Kukes	142	134	-8	-6	56
Lezhe	168	166	-2	-1	103
Shkoder	316	275	-41	-13	77
Tirane	492	569	77	16	344
Vlore	267	263	-4	-1	97
Total	3,202	3,283	81	23	114

Burimi:: INSTAT, Disa tregues sociale te prefeturave, 1998

Tabela 1/1 Dendësia e popullsisë, 1997 (sipas projeksioneve)

No.	Rrethi	Dendësia per km2
Grupi I pare		30-50
1	Kolonje	30
2	Permet	38
3	Tropoje	39
4	Puke	40
5	Mirdite	50
Grupi I dyte		51-100
6	Has	52
7	Tepelene	54
8	Skrapar	55
9	Gjirokaster	56
10	Gramsh	63
11	Mat	64
12	Librazhd	68
13	Kukes	78
14	Malesi e Madhe	79
15	Sarande	82
16	Delvine	83
17	Devoll	83
18	Diber	93
19	Korce	95
20	Shkoder	96
21	Pogradec	98
Grupi I trete		100-150
22	Bulqize	107
23	Mallakaster	108
24	Vlore	108
25	Lezhe	138
26	Berat	145
Grupi I katert		150-200
27	Elbasan	158
28	Kruje	178
29	Lushnje	196
Grupi I peste		200-300
30	Kurbin	207
31	Kavaje	213
32	Fier	265
33	Peqin	289
Grupi I gjashte		300-400
34	Tirane	388
Grupi I shtate		mbi 400
35	Durres	437
36	Kucove	462
Dendësia mesatare		114

Burimi: INSTAT, Vjetar Demografik, 1998

Tabela 1/2 Ndryshimet ne popullsine urbane ne disa qytete, 1990 - 1997

	Qytetet	Popullsia urbane 1990	Popullsia urbane 1997	Ndryshimi	Ne %
1	Berat	43,800	60,796	16,996	39
2	Peshkopi	13,300	18,684	5,384	40
3	Durres	85,400	104,029	18,629	22
4	Elbasan	83,300	105,101	21,801	26
5	Fier	45,200	69,979	24,779	55
6	Gramsh	8,200	16,218	8,018	98
7	Gjirokaster	24,900	30,658	5,758	23
8	Kavaje	25,600	31,530	5,930	23
9	Korce	63,600	74,905	11,305	18
10	Kruje	14,300	14,052	-248	-2
11	Kucove	22,300	27,637	5,337	24
12	Kukes	13,300	22,049	8,749	66
13	Kurbin	13,600	25,009	11,409	84
14	Lezhe	10,600	16,592	5,992	57
15	Librazhd	5,100	9,916	4,816	94
16	Lushnje	31,500	46,575	15,075	48
17	Burrel	11,200	16,698	5,498	49
18	Rresheni	4,400	7,898	3,498	80
19	Peqin	6,800	8,749	1,949	29
20	Permet	7,600	10,508	2,908	38
21	Pogradec	20,100	28,060	7,960	40
22	Puke	3,300	5,866	2,566	78
23	Sarande	16,400	23,058	6,658	41
24	Corovode	7,900	10,255	2,355	30
25	Shkoder	79,900	93,739	13,839	17
26	Tepelene	7,400	8,873	1,473	20
27	Tirane	238,000	345,049	107,049	45
28	Bajram Curri	7,800	12,542	4,742	61
29	Vlore	73,800	86,107	12,307	17

Burimi:

INSTAT, Vjetari statistikor 1989,

INSTAT, Vjetari statistikor I demografise, 1998

Tabela 2 Ndermarrjet e huaja dhe te perbashketa ne qytete, 1999

No.	Qytetet	Numri I ndermarrjeve te perbashketa	Numri I punetoreve	Numri I ndermarrjeve te huaja	Numri I punetoreve
1	Berat	9	155	1	3
2	Bulqize	2	18	1	3
3	Delvine	3	6		
4	Devoll	6	407		
5	Diber	1	3		
6	Durres	153	1,489	107	1,197
7	Elbasan	45	438	5	5
8	Fier	26	473	6	22
9	Gramsh				
10	Gjirokaster	104	1,241	9	12
11	Has				
12	Kavaje	9	47	2	12
13	Kolonje				
14	Korce	57	1,636	20	729
15	Kruje	1	1	2	564
16	Kucove				
17	Kukes	1	2	1	2
18	Lac	5	11	2	3
19	Lezhe	6	43	2	158
20	Librazhd	2	89	1	199
21	Lushnje	8	544	1	100
22	Malsi e Madhe	5	16		
23	Mallakaster	3	14		
24	Mat				
25	Mirdite				
26	Peqin	3	23		
27	Permet	1	3		
28	Pogradec	7	48	2	5
29	Puke	1	15		
30	Sarande	13	77	2	2
31	Skrapar	2	7		
32	Shkoder	26	719	13	269
33	Tepelene	1	2		
34	Tirane	1,096	6,042	968	5,867
35	Tropoje				
36	Vlore	17	191	2	39
37	Tirane	55	263	27	64
	TOTAL	1668	14023	1174	9255

Burimi: INSTAT, 2000

Tabela 2/1 Investimet e huaja dhe ndermarrjet e perbashketa sipas aktivitetit, 1999

No	Aktivitetit	Numri I ndermarrjeve te huaja dhe te perbashketa	Ne %	Numri I punetoreve	Ne %
1	Bujqesi dhe frutikulture	33	1	555	2
2	Peshkim	10	0	48	0
3	Nenprodukte energjitike	1	0	6	0
4	Nenprodukte jo energjitike	13	1	94	0
5	Industri ushqimore	112	4	1,392	6
6	Industri tekstile dhe veshje	129	5	5,228	23
7	Industri lekure dhe kepuce	55	2	4,023	17
8	Industri e drurit	38	1	462	2
9	Industri e letres	30	1	429	2
10	Industri kimike	47	2	201	1
11	Prodhim I mallrave jo metalike	56	2	1,064	5
12	Metalurgji dhe metale	45	2	211	1
